

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5867
E hënë, 2 shtator 2019
çmimi 0.40 €

Matthew Palmer,
përfaqësues i posaçëm
i ShBA-së për Ballkanin
Perëndimor | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**SOT FILLON VITI I RI
SHKOLLOR 2019-2020** F. 5

**RYSHFETI S'ËSHTË FAKTORI
I VETËM I TËRHEQJES
SË NJOHJEVE** F. 7

**FILLON PERIUDHA E APLIKIMIT
PËR ÇMIME TË BARNAVE** F. 6

**VESELI BËN HOMAZHE TE
VARREZAT E DËSHMORËVE NË
STANOVIC DHE LANDOVICË** F. 6

EKONOMI



**PËRGJYSMOHET SIPËRFAQJA E
TOKËS SË MBJELLË ME GRURË** F. 9

**PËRFUNDON ME SUKSES
CIKLI I INVESTIMEVE KAPITALE
NË REMONTET E BLOQEVE
TË KEK-ut** F. 8

SPORT

**CHALLANDESI:
KUNDËRSHTARËT
JANË TË FORTË, POR TË
LUFTOJMË SI EKIP** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", QEMAJL MUSTAFA | FAQE 4-5



Pas 6 tetorit Kadri Veseli do të jetë kryeministër

- PDK-ja dhe LDK-ja garojnë
për vendin e parë, LV-ja dhe
AAK-PSD-ja për vendin e tretë

Kryetari i Degës së Partisë
Demokratike të Kosovës (PDK) në
Gjilan, Qemajl Mustafa, ka bërë me
dije se ky subjekt politik ka hequr dorë
nga koalicionet parazgjedhore meqë
në të kaluarën është dëmtuar nga to.

Ai ka thënë se gara zgjedhore e 6
tetorit do të jetë interesante dhe
konkurruese. Në këtë intervistë dhënë
për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka
deklaruar se PDK-ja dhe LDK-ja
garojnë për vendin e parë, kurse LV-ja

dhe AAK-PSD-ja për vendin e tretë. Ai
ka thënë se pas 6 tetorit Kadri Veseli
do të jetë kryeministër. Sipas tij, vetëm
PDK-ja mund të marrë vendime të
mëdha dhe ta luftojë krimin dhe
korrupsionin

Liderët kërkojnë vota nga të rinjtë

| FAQE 3



Pas regjistrimit të katër koalicioneve
parazgjedhore që do të marrin pjesë
në zgjedhje parlamentare të 6
tetorit, liderët e subjekteve politike
kanë vazhduar parafushatën
zgjedhore duke takuar grupe të
ndryshme të interesit dhe duke
prezantuar aderimet e reja.
Kandidatët për kryeministër kanë
vlerësuar lart rininë e vendit, duke
besuar në profesionalizmin e saj.
Ata kanë deklaruar se vetëm me të
rinj të pakomprometuar Kosova
mund të ndryshojë

**Aeroporti
'Adem
Jashari'
thyen rekord
të ri, në
muajin gusht
mbi 300 mijë
udhëtarë**

| FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vnua, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Matthew Palmer, përfaqësues i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor

Departamenti amerikan i Shtetit ka njoftuar se në këtë rol Palmer do t'i udhëheqë përpjekjet tona për ta fuqizuar angazhimin diplomatik amerikan në mbështetje të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon dhe në fokusimin në integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në institucionet perëndimore



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, do të jetë përfaqësues i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor. Në njoftimin e Departamentit të Shtetit, thuhet se në këtë rol Palmer do t'i "udhëheqë përpjekjet tona për ta fuqizuar angazhimin diplomatik amerikan në mbështetje të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon dhe në fokusimin në integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në institucionet perëndimore".

Në këtë kapacitet, Palmeri do të udhëtojë në Slloveni, për të marrë pjesë në Forumin Strategjik në Bled, thuhet më tutje në njoftim. Ai do t'i përfaqësojë Shtetet e Bashkuara

në takimin e drejtorëve për Ballkanin të vendeve anëtare të Quintit në Bruksel, si dhe do të marrë pjesë në takime në Vjenë dhe Podgoricë nga 4 deri më 10 shtator.

Përveç angazhimit si përfaqësues i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Palmeri do të vazhdojë të jetë zëvendësndihmëssekretar amerikan i Shtetit në Zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike, një post që ai mban që nga viti 2018. Më parë ai ishte drejtor i Zyrës për Evropën Jugore dhe Qendrore. Eksperti amerikan i zhvillimeve politike në Ballkan, Daniel Serwer, ka thënë se emërimi i Mathew Palmer si përfaqësues special i sekretarit amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor është një tendencë për të arritur një

marrëveshje të nxituar midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, kjo është një tendencë për të nxituar drejt arritjes së një marrëveshje përpara nëntorit të vitit 2020 kur edhe mbahen zgjedhjet presidenciale në ShBA. "Pas emërimit unë do të shpresoj për një politikë më të qartë të ShBA-së për shkëmbimin e territoreve dhe

për një koordinim më të mirë me Evropën, por kam frikë se kjo është një tendencë për të nxituar drejt arritjes së një marrëveshje përpara nëntorit të vitit 2020 kur edhe mbahen zgjedhjet presidenciale", ka thënë Serwer për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe. "Emërimi i një përfaqësuesi special nuk është një vendim i

lehtë për t'u marrë. Qëllimi është që ai të flasë si përfaqësues dhe të ketë respekt më të madh pasi që do të flasë në emër të Sekretarit të Shtetit. Është e qartë që tregojnë qëllimin e ShBA-së për të pasur ndikim sa më të madh në rajon dhe me siguri për të pasur një zgjidhje të problemit të Kosovës", tha Serweri.

Khafaj: Emërimi i Palmerit për Ballkanin, lajm pozitiv



TIRANË, 1 SHTATOR - Caktimin e Matthew Palmerit si përfaqësues i posaçëm për Ballkanin Perëndimor e ka përshëndetur edhe ish-ministri Fatmir Xhafaj. "Është një lajm shumë i mirë jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë

rajonin, për forcimin e bashkëpunimit, dialogut dhe sigurisë rajonale. Faleminderit Departamentit të Shtetit për rritjen e vëmendjes për rajonin dhe për Shqipërinë në këto çaste kritike.

Jam i bindur se kontributi i

Palmerit për Shqipërinë do të përmirësohet më tepër, sidomos për konsolidimin e rregullit dhe ligjit dhe reformën në drejtësi, luftën ndaj korrupsionit dhe krimin e organizuar. Ka qenë kënaqësi e veçantë të ndaj me të shqetësimin për

këto tema gjatë vizitës sime në Uashington, në mars 2018 dhe të shoh tek ai interesimin dhe kujdesin e veçantë për integrimin e shpejtë. Sukseset e Palmerit në këtë mision shprehe për rajonin, për vendin tim", tha Xhafaj.

Kuvendi nis punën me ligje të vjetra, opozita në protesta të fuqishme

TIRANË, 1 SHTATOR - Sot (e hënë) qeveria rikthehet në Kuvend bashkë me deputetët e mazhorancës, pas pushimeve verore. Sipas kalendarit, ligjvënësit rinisin punën me ligjet e vjetra. Rrëzimi i 9 dekreteve nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, për kthim ligjesh do të jenë ndër vendimet e para që Kuvendi pritet t'i marrë këtë vjeshtë. Ligji për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ai për koncesionet dhe PPP-të, Kodi Penal, Ligji për planifikimin e territorit, rezervat e shtetit,

vetëqeverisjen vendore, shërbimin përmbartimor privat si dhe dy koncesionet e rrugëve Orikum-Llogara dhe Milot-Balldren, pritet të rivotohen të pandryshuara pavarësisht prej vërejtjeve të presidentit.

Këtë sesion që nis pasditen e kësaj të hëne do të testohet edhe fati i reformës zgjedhore, e kryesuar nga Rudina Hajdari dhe Damian Gjoknuri. Opozita ka vendosur kusht për pjesëmarrje në komisionin e posaçëm që do ta ndryshojë Ligjin e zgjedhjeve largimin e

ish-ministrit. Paketa antishpifje, e propozuar nga qeveria, pritet të jetë një tjetër sfidë për Kuvendin jo vetëm mes vetes, por edhe me përfaqësuesit e medias.

Nga ana tjetër, opozita e cila nuk ka reshtur së denoncuari skandalet e qeverisë ka thënë se në shtator rinisin dhe protestat të cilat kësaj here duken se nuk do të jenë aq të qeta, pasi që PD-ja ka akuzuar dhe denoncuar me fakte veprat penale që kanë kryebashkiakët e PS-së që dolën nga votimet e 30 qershorit. PD, LSI



dhe partitë e vogla do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 13

tetorit, të dekretuara nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta.

Katër koalicione parazgjedhore për zgjedhjet e 6 tetorit janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Liderët kërkojnë vota nga të rinjtë

Pas regjistrimit të katër koalicioneve parazgjedhore që do të marrin pjesë në zgjedhje parlamentare të 6 tetorit, liderët e subjekteve politike kanë vazhduar parafushatën zgjedhore duke takuar grupe të ndryshme të interesit dhe duke prezantuar aderimet e reja. Kandidatët për kryeministër kanë vlerësuar lart rininë e vendit, duke besuar në profesionalizmin e saj. Ata kanë deklaruar se vetëm me rinjtë të pakomprometuar Kosova mund të ndryshojë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ndonëse pritjet ishin se mund të ndodhë ndonjë koalicion parazgjedhor i madh në minutat e fundit të së premtes, nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK-ja) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV-ja), pavarësisht se ishin afër arritjes së një koalicioni, vendosen të shkojnë veçmas në zgjedhjet e 6 tetorit, ashtu sikurse Partia Demokratike e Kosovës (PDK-ja). Pas mbarimit të afateve për

Liderët politikë të cilët do të jenë kandidatë për kryeministër kanë vazhduar aktivitetet e tyre edhe pas regjistrimit të subjekteve politike, duke u shprehur të bindur në fitoren e tyre më 6 tetor. Kandidati i PDK-së për kryeministër, Kadri Veseli, ka deklaruar të dielën se ka shumë besim te të rinjtë, duke shtuar se vetëm me të rinjtë e pakomprometuar lufta për sundimin e ligjit fitohet shumë më shpejt. "Para disa ditësh e vizitova Akademinë për Siguri Publike, që si institucion shtetëror po na

dhënë hapësirë të rinjve do të krijohet një perspektivë e sigurt për vendin. "Unë besoj te rinia e Kosovës dhe jam i sigurt se duke u dhënë më shumë hapësirë atyre, ne do të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për vendin. Obligimi im është të krijoj kushte pune dhe mbështetje sa më të madhe për këta policë të rinj, që të jenë sa më efikas dhe të përkushtuar në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar", ka vlerësuar Veseli.

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, teksa ka pranuar një grup profesionistësh të rinj në subjektin e tij politik, ka thënë se vetëm me të rinj bëhet ndryshimi në Kosovë. "Një grup profesionistësh të rinj nga Skenderaj, të cilët vijnë nga rrugë të ndryshme të jetës brenda dhe jashtë Kosovës, u anëtarësuan në Lëvizje. Të rinjtë prijnë për ndryshimin. Gjithandëj Kosovës, edhe në Skenderaj dhe Drenicë. Ne i zëmë besë drejtësisë dhe u besojmë të rinjve të Kosovës. Na duhet ndryshimi sepse të rinjtë na duhen këtu, që bashkë ta zhvillojmë Kosovën", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Derisa kandidati për kryeministër i koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, ka takuar kryetarët e komunave që qeverisen nga AAK-ja, duke thënë se vetëm me qeverisjen e tij Dukagjini është rikthyer në hartën e investimeve të mëdha. "Me kryetarët e Aleancës nga Gjakova, Peja, Klina, Deçani dhe Juniku, të mobilizuar për fitore në zgjedhjet që i kemi përpara. Gjatë kësaj periudhe të qeverisjes vepruese,



regjistrimin e koalicioneve parazgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) ka treguar se në këto zgjedhje do të garojnë katër koalicione: Koalicioni AAK-PSD, koalicioni Nisma-AKR-PD, koalicioni Vatak, i përbërë nga tri parti (Partia Demokratike Boshnjake, Partia Demokratike Vatan dhe Partia e Bashkuar Boshnjake), si dhe koalicioni i quajtur Sloboda (Liria), i cili përbëhet nga Partia Përparimtare e Kosovës dhe Partia e Re e Kosovës.

bënë shumë krenarë. E përgëzova stafin akademik dhe administrativ të saj për punën e shkëlqyer që po bëjnë në përgatitjen e policëve të rinj dhe i falënderova kadetët që kanë zgjedhur profesionin fisnik të policit. Me të rinj të tillë, plot energji, të kualifikuar, të pakomprometuar dhe në nivel të lartë të detyrës dhe përgjegjësisë, lufta për sundimin e ligjit fitohet shumë më shpejt", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook". Ai ka vlerësuar se vetëm duke u

Dukagjini është rikthyer në hartën e investimeve të mëdha. Mbështetja e fuqishme për projektin 100 për qind shtet është garanci për qëndrueshmëri dhe zhvillim dinamik të tërë Kosovës", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministër, Vjosa Osmani, të dielën ka qëndruar në qytetin e Prizrenit, me ç'rast u është drejtuar qytetarëve me një fjalim rasti. "Ne sot kemi një betejë mes ikjes dhe qëndrimit. Mes ikjes dhe qëndrimit ne kemi zgjedhur qëndrimin dhe e kemi zgjedhur përballjen", ka thënë Osmani. Ajo ka folur edhe për problemin e largimit të të rinjve nga vendi. "Rinia ka mendjen e largimit nga Kosova. E ne duam që të rinjtë pasaportën mos ta kenë dokument

për ikje, por ta kenë stemë të krenarisë, të mburren me shtetin e tyre", ka thënë Osmani, duke shtuar se i ka hyrë garës me mesazhin kryesor që "shtetin e kapur nga partitë në pushtet, t'ua kthejë qytetarëve".

Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka thënë se po ndodh mobilizim i jashtëzakonshëm i strukturave drejtuese të rinisë së Nismës Socialdemokrate. "Djem dhe vajza të reja të mobilizuar si asnjëherë më parë për t'i sjellë një rezultat të madh Nismës në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Rinia e Nismës është promotore e zhvillimit dhe forcimit të partisë sonë. Nisma ka dëshmuar se është partia që promovon dhe ua jep hapësirën më të madhe të rinjve dhe këtë praktikë do ta ndjekim edhe më tutje", ka thënë Limaj.

KQZ-ja ka njoftuar se afati për aplikim për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për zgjedhjet e parakohshme parlamentare përfundon të premten, më 6 shtator.


Zgjedhjet e 6 tetorit vijnë pasi Ramush Haradinaj më 19 korrik dha dorëheqje nga pozita e kryeministrit, pasi u thirr në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte nga Prokuroria Speciale në Hagë.



Flet për "Epokën e re", Qemajl Mustafa

Pas 6 tetorit Kadri Veseli

- PDK-ja dhe LDK-ja garojnë për vendin e parë, LV-ja dhe AAK-PSD-ja për vendin e tretë



Kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka bërë me dije se ky subjekt politik ka hequr dorë nga koalicionet parazgjedhore meqë në të kaluarën është dëmtuar nga ato. Ai ka thënë se gara zgjedhore e 6 tetorit do të jetë interesante dhe konkurruese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka deklaruar se PDK-ja dhe LDK-ja garojnë për vendin e parë, kurse LV-ja dhe AAK-PSD-ja për vendin e tretë. Ai ka thënë se pas 6 tetorit, Kadri Veseli do të jetë kryeministër. Sipas tij, vetëm PDK-ja mund të marrë vendime të mëdha dhe ta luftojë krimin dhe korrupsionin

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka thënë se kjo parti nuk ka dashur të bëjë koalicione parazgjedhore meqë ato e kanë dëmtuar në të kaluarën. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se gara zgjedhore e 6 tetorit do të jetë interesante dhe konkurruese. Sipas Mustafës, PDK-ja dhe LDK-ja do të garojnë për vend të parë, kurse LV-ja dhe koalicioni AAK-PSD për vendin e tretë. "Ne nuk kemi tentuar të bëjmë koalicion parazgjedhor sepse nga kjo lidhje kemi pasur mjaft dëme nga e

Vazhdon fluksi në Merdar, deri në dy orë pritje për të dalë nga Kosova

MERDAR, 1 SHTATOR - Kufiri i Merdarit vazhdon të përballet me fluksin e udhëtarëve që duan të dalin nga Kosova. Raportohet se qytetarët dety-

rohet të presin në Doganë deri në dy orë. Kështu ka njoftuar Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar. E kundërta ndodh në anën

tjetër të Doganës, ku për të hyrë në Kosovë, qytetarët presin vetëm 5-10 minuta. Kolona e automjeteve raportohet se është rreth 500 metra

e gjatë. Ndërkohë, në pikën kufitare të Dheu i Bardhë pritet për të dalë nga Kosova janë 30 minuta. Pikat e tjera kufitare të Kosovës me shtetet

fqinje janë më pak të ngarkuara. Pritjet hyrje-dalje janë jo më shumë se 15 minuta dhe nuk raportohet për radhë të gjata.

do të jetë kryeministër



mën e saj të brendshme dhe me risitë programore dhe në listën e kandidatëve do të jetë larg më atraktive dhe më joshëse për publikun e Kosovës. Ka pasur edhe ndonjë lëshim e gabim nga e kaluara, por PDK-ja di dhe guxon edhe të korrigohet, edhe të vazhdojë të marrë vendime të mira e të mëdha", ka theksuar ai, duke shtuar se PDK-ja sa e ka të metë qeverisjen e gjatë, atë e ka edhe përparësi. "Asaj populli i Kosovës i beson për vendimet e mëdha dhe të mirat që ia ka sjellë këtij vendi, por edhe e akuzon për disa gabime dhe lëshime", ka deklaruar Mustafa. Sipas tij, vetëm PDK-ja dhe Kadri Veseli mund të marrin vendime të mëdha dhe ta luftojnë krimin e korrupsionin. "Krimi dhe korrupsioni janë kontribut i të gjithëve që e qeverisen Kosovën. PDK-së i vishen më shumë gabime sepse qeverisi më së gjati, por asaj edhe i jepet merita nga populli për lirinë e vendit, për pavarësinë dhe për krejt makroinfrastrukturën që ka ndodhur në Kosovë. Ata që kanë ditur të bëjnë kthesa historike nga e kaluara jo e largët, dinë të bëjnë edhe këtë kthesë të madhe e që është lufta e pakompromis sistemore e së keqes brenda nesh si krimi, korrupsioni dhe nepotizmi", ka thënë Mustafa.

"Epoka e re": Z. Mustafa, PDK-ja ka vendosur të garojë e vetme në zgjedhjet e 6 tetorit. Pse këtë herë nuk bëtë koalicion parazgjedhore? Dëshironi t'i masni forcat të vetëm apo ju refuzuan partitë e tjera?

Mustafa: Ne nuk kemi tentuar të bëjmë koalicion parazgjedhor sepse nga kjo lidhje kemi pasur mjaft dëme nga e kaluara. Lidhja parazgjedhore e quajtur PAN vetëm sa i ka sjellë dëme të mëdha PDK-së. I ka bërë dëm të konsiderueshëm në vota, por edhe gjatë gjithë mandatit të z. Haradinaj me krejt skandalet e bëra nga ai dhe qeverisja e tij.

"Epoka e re": Edhe dy partitë e tjera garojnë te vetme, LDK-ja dhe LV-ja, si dhe në garë do të jenë dy koalicionet nga radhët e shqiptarëve. Si e shihni këtë garë?

Mustafa: Gara do të jetë interesante dhe mjaft konkurruese

sepse ata që po garojnë këtë herë kanë trup relativisht të mirë zgjedhor. Janë dy partitë e mëdha që tradicionalisht janë rivale dhe luftojnë për vendin e parë dhe LV-ja e AAK-ja me PSD-në që luftojnë për vendin 3 dhe 4. PDK-ja me reformën e saj të brendshme dhe me risitë programore dhe në listën e kandidatëve do të jetë larg më atraktive dhe më joshëse për publikun e Kosovës. Ka pasur edhe ndonjë lëshim e gabim nga e kaluara, por PDK-ja di dhe guxon edhe ta korrigojë, edhe të vazhdojë të marrë vendime të mira e të mëdha.

"Epoka e re": Sa do të jetë sfidues për PDK-në ky proces zgjedhor duke pasur parasysh se është në pushtet prej vitit 2007?

Mustafa: PDK-ja sa e ka të metë qeverisjen e gjatë, atë e ka edhe përparësi. Asaj populli i Kosovës i beson për vendimet e mëdha dhe të mirat që ia ka sjellë këtij vendi, por edhe akuzon për disa gabime dhe lëshime. PDK-së i besohet kur kërkon falje derisa të tjerave nuk u besohet as kur bëjnë ndonjë punë të mirë.

"Epoka e re": Fushata e PDK-së do të bazohet në premtimin për luftimin e korrupsionit dhe nepotizmit. Si do t'i luftoni këto dukuri kur të gjitha partitë e akuzojnë PDK-në se i ka instaluar në shtet këto dy të këqija?

Mustafa: Krimi dhe korrupsioni janë kontribute të të gjithëve që e qeverisen Kosovën. PDK-së i vishen më shumë gabime sepse qeverisi më së gjati, por asaj edhe i jepet merita nga populli për lirinë e vendit, për pavarësinë dhe për krejt makroinfrastrukturën që ka ndodhur në Kosovë. Ata që kanë ditur të bëjnë kthesa historike nga e kaluara jo e largët, dinë të bëjnë edhe këtë kthesë të madhe e që është lufta e pakompromis sistemore e së keqes brenda nesh si krimi, korrupsioni dhe nepotizmi.

"Epoka e re": Si po ju ecën fushata në Anamoravë dhe a pritet të ketë ndryshime në këtë pjesë, pra të kthehet vota pro PDK-së?

Mustafa: Fushata po shkon mirë. Dega në Gjilan dhe të tjerat në Anamoravë janë konsoliduar dhe po e bëjnë

maksimumin për të dalë fituese sivjet. Thjesht, mua dhe Degës në Gjilan si fitues serikë edhe në nivelin lokal edhe në atë nacional populli i kësaj ane na beson shumë.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet e PDK-së nga zgjedhjet dhe pse besoni se Kadri Veseli do të zgjedhet kryeministër?

Mustafa: Pritjet në Anamoravë dhe Gjilan janë fort të mira sepse qytetarët janë mërziur me zhvatjet, rrenat e mashtrimet e Lutfi Hazirit dhe sejmeneve të tij si dhe u besojnë përcaktimeve të mia si udhëheqës lokal i degës dhe Kadri Veselit si njeri i fjalës dhe i guximit për t'i çuar gjërat përpara. Kadri Veseli është i vetmi lider të cilit Amerika aktualisht i beson 100 për qind dhe mbështetet në të. Kadri Veseli nuk luan me dy kute me Amerikën dhe me BE-në. Është i qartë dhe është partner i vërtetë i tyre ashtu qysh ata janë partnerët tanë strategjikë.

"Epoka e re": Kush do ta qeverisë Kosovën pas 6 tetorit dhe kush do të mbetet në opozitë?

Mustafa: Pas 6 tetorit Kosovën e qeveris njeriu dhe subjekti politik të cilit i beson populli i Kosovës që mund ta përfundojë marrëveshjen me Serbinë dhe ta lëmë në histori të kaluarën e gjatë konfliktit në këto hapësira. Kjo assesi nuk bëhet pa besimin dhe pa ndihmën e BE-së dhe të ShBA-së. Partnerët dhe populli i Kosovës edhe kësaj here do t'i besojnë formacionit që di dhe guxon të marrë vendime të rëndësishme e të rënda, e ai është vetëm dhe vetëm PDK-ja me Kadri Veselin në krye. Paralelisht, me përmbylljen e shtetësisë së plotë, lideri i PDK-së bashkë me të gjithë dijen vendore dhe ndërkombëtare do ta bëjë kthesën në stabilizimin e rrjedhave në ekonomi, në edukim, në shëndetësi, në administratë dhe në siguri dhe gjithandaj. Modeli i Uran Ismailit në shëndetësi është për admirim. Vetëm për dy vjet ky ministër arriti të bëjë kthesë gjigante në sistemin e shëndetësisë, veçanërisht në ShSKUK. Pra, është e qartë. Pas 6 tetorit, kryeministër do të jetë Kadri Veseli e PDK-ja lidere në qeverisje të vendit.

kaluara. Lidhja parazgjedhore e quajtur PAN vetëm sa i ka sjellë dëme të mëdha PDK-së. I ka bërë dëm të konsiderueshëm në vota, por edhe gjatë gjithë mandatit të z. Haradinaj me krejt skandalet e bëra nga ai dhe qeverisja e tij. Gara do të jetë interesante dhe mjaft konkurruese, sepse ata që po garojnë kësaj here kanë trup relativisht të

mirë zgjedhor. Janë dy partitë e mëdha që tradicionalisht janë rivale dhe luftojnë për vendin e parë dhe LV-ja e AAK-ja me PSD-në që luftojnë për vendin tretë dhe të katërt", është shprehur ai. Mustafa ka thënë se PDK-ja do të jetë alternativa më e mirë për qytetarët e Kosovës edhe në këto zgjedhje. "PDK-ja me refor-

Sot fillon viti i ri shkollor 2019-2020

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Sot (e hënë) fillon viti i ri shkollor 2019-2020. Me këtë rast ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në

orën 10:00, do ta vizitojë Shkollën Fillore "Vaso Pashë Shkodrani" në Leshan të Suharekës. Ndërkaq kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Karaçevë e Poshtme, Selver

Lenjani, ka bërë me dije se më 2 shtator do të protestohet kundër mbylljes së nëntëmbëdhjetë shkollave fillore në Komunën e Kamenicës, përkatësisht në brezin

kufitar. Ai ka thënë se mbyllja e këtyre shkollave është shqetësuese për banorët e Karaçevës prandaj, sipas Lenjanit, nuk do të mbetet gurë pa lëvizur për të

parandaluar një gjë të tillë. Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se nuk do të ketë mbyllje të shkollave, por riorganizim të tyre.

Ilir Deda nuk do të garojë për deputet

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, nuk do të garojë në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se edhe pse i është ofruar hapësirë në disa lista zgjedhore, nuk do të jetë pjesë e këtyre zgjedhjeve. "I falënderoj të gjithë ata që u munduan të më bindin të bashkohemi. Unë nuk dua të punoj kundër bindjeve të mia. Kjo nuk do të thotë se do ta për-

fundoj angazhimin tim publik si qytetar dhe aktivist politik. Thjesht, refuzoj të bëhem pjesë e 'lojës' ku rezultati i kërkuar, ndryshimi thelbësor që e dua, nuk besoj se do të arrihet në zgjedhjet e radhës. Rrjedhimisht, nuk shoh vlerë që të marrë pjesë në to", ka shkruar Deda.

Ai ka thënë se më 8 dhjetor të vitit 2018 kishte paralajmëruar mundësinë e moskandidimit të tij në zgjedhjet e radhës. "Ndër

të tjera, thashë se 'elita politike në pozitë e opozitë, e verbëruar nga konfliktet personale, nuk do që të japë përgjigje e të marrë përgjegjësi për Republikën tonë të Kosovës. Në vend se të jetë fitorja politike e Kosovës prioritet, te ne është më e rëndësishme fitorja partiake individuale. Prandaj, refuzoj të jem pjesë e kësaj lloj politike, esencialisht primitive dhe skajshmërisht e papërgjegjshme", ka thënë ish-deputeti Ilir Deda.



Fillon periudha e aplikimit për çmime të barnave

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Të dielën ka filluar periudha e aplikimit për çmime të barnave, e cila do të zgjasë deri më 30 shtator, pas së cilës, pastaj do të bëhet shqyrtimi dhe analiza e këtyre aplikacioneve sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë udhëzim.

Javën e kaluar komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve mjekësore ka mbajtur takimin e radhës, me ç'rast edhe ka marrë disa vendime në funksion të zbatimit të plotë të Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin dhe unifikimin e çmimeve të produkteve mjekësore në sektorin farmaceutik në vend.

Ky udhëzim do t'i rregullojë çmimet e produkteve të cilat

janë pjesë e furnizimeve për institucione publike shëndetësore, atyre të cilat do të jenë të rimbursuara nga ana e Fondit për Sigurime Shëndetësore dhe, në fund, por jo më pak e rëndësishme, për produktet mjekësore të cilat janë subjekt i përshkrimit mjekësor (recetës) në mënyrë që ta adresojmë në tërësi këtë problematikë të çmimeve të produkteve mjekësore.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur ka miratuar Rregulloren e punës si dhe anëtarët e komisionit kanë nënshkruar Deklaratën mbi konfliktin e interesit. Sipas afateve të përcaktuara, në këtë fazë është aprovuar edhe plani i veprimit si dhe afatet për hapjen e periudhës së aplikimeve nga mbajtësit e autorizimit të marketingut për çmimet e produkteve mjekësore.



Formati i aplikacionit është shtojcë e Udhëzimit Administrativ dhe obligues për t'iu përmbajtur duke e dorëzuar atë të plotësuar në arkiv të Ministrisë së Shëndetësisë për Divizionin e Farmacisë - Sekretarinë Teknike

të Udhëzimit 02/2019. Gjithashtu, i njëjti aplikacion në formatin elektronik në Excel duhet të dorëzohet edhe në e-mail adresën e MSh-së.

Të dhënat lidhur me udhëzimin, aplikacionet, afatet dhe infor-

mata të tjera të rëndësishme rreth këtij procesi gjithashtu do të publikohen në uebfaqen e Ministrisë së Shëndetësisë (msh-rks-gov.net) dhe do të jenë të qasshme për palët e interesuara.



Veseli bën homazhe te varrezat e dëshmorëve në Stanovc dhe Landovicë

Vushtrri, 1 shtator - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, për nder të Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së në Komunën e Vushtrrisë, bashkë me familjarë të dëshmorëve, me veteranë dhe invalidë të UÇK-së, kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në Stanovc. Po ashtu, në përkujtim të 21-vjetorit të Epopesë së Vërrinit dhe rënies së heroit Xhevat Berisha, në shenjë nderimi për jetën dhe

veprën e tij, kanë bërë homazhe edhe te varrezat e dëshmorëve në Landovicë. "Lirinë dhe pavarësinë i kemi arritur falë sakrificës sublime të luftëtarëve të lirisë, që dhanë gjithçka për atdheun tonë. Vepra e tyre do të shërbejë përherë si pishtar ndriçues në rrugëtimin e brezave të rinj dhe si burim frymëzimi në përpjekjet tona për të ndërtuar një të ardhme më të mirë në Kosovë", ka thënë Veseli.

Lluka: AKR-ja mbetet përcaktuese në vendimet për fatin e shtetformimit të Kosovës

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Zyrtari i lartë i Aleancës Kosova e Re (AKR), Valdrin Lluka, ka mbajtur një takim pune me koordinatorët e disa prej degëve të AKR-së, me të cilët ka diskutuar për parapërgatitjet për fushatën elektorale për zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 6 tetor. "AKR-ja që prej

themelimit të saj në vitin 2006, si në pozitë, ashtu edhe në opozitë, ka qenë dhe mbetet përcaktuese në të gjitha vendimet e mëdha që kanë përcaktuar fatin e shtetformimit të Kosovës në qasjen e saj pro institucionale. Faza e shtetndërtimit kërkon parti politike të cilat respektojnë themelet e shtetësisë dhe qeverisin me

duar të pastra, shembull të cilin AKR-ja tashmë e ka dhënë", ka thënë Lluka. Ai ka theksuar se vlerat liberale që përçohen nga AKR-ja e që në thelb të tyre kanë zhvillimin ekonomik, punësimin, fuqizimin e sektorit privat, barazinë dhe rininë janë qëllime të cilat i nevojiten Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.



Ryshfeti s'është faktori i vetëm i tërheqjes së njohjeve

Prishtinë, 1 shtator - Mungesa e kultivimit të marrëdhënieve me disa nga vendet që e kanë njohur Kosovën, konsiderohet si një prej faktorëve që po çon në tërheqjen e këtyre njohjeve, thonë njohës të marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas tyre, Kosova duke lënë anash kultivimin e raporteve dhe marrëdhënieve me këto vende, u ka lënë hapësirë veprimi diplomatike nga Rusia dhe Serbia që të bindin disa prej këtyre shteteve që t'i tërheqin njohjet. Së fundmi, Ministria e Jashtme e Kosovës ka akuzuar Qeverinë e Serbisë dhe kabinetin e ministrit të Jashtëm serb, Ivica Dačić, për blerjen e tërheqjes së njohjeve të Kosovës. "Ne jemi thellësisht të shqetësuar që qeveria serbe ka instaluar korrupsionin dhe ryshfetin si mjete diplomatike për të pranuar dokumente të falsifikuara që nuk shërbejnë asgjë, por vetëm për përshkallëzimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme të Kosovës.

I përfshirë në aferën e, siç thuhet, ryshfetit për tërheqjen e njohjeve, përmendet këshilltari i ministrit të Jashtëm të Serbisë, Vladimir Cizelj, i cili thuhet se "është i njohur për të kaluarën e tij kriminale dhe lidhjet me rrjetet e kriminit të organizuara jashtë Evropës".

Origjina e fushatës së Serbisë për t'i pakësuar njohjet ndërkombëtare të Kosovës, sipas njohësve të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërlihet edhe me stagnimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Profesori Gëzim Visoka, i cili është ligjërues në Dublin City University në Irlandë, thotë se Serbia që nga momenti kur ka parë se Kosova nuk është në gjendje ta formojë Asociacionin e Komunave Serbe në versionin e Beogradit dhe që kur ishte bindur se as trysnia ndërkombëtare mbi Kosovën nuk po funksiononte më, filloi të hapë një front diplomatik kundër shtetit të Kosovës. "Në esencë, çnjohja e Kosovës ka të bëjë me fuqizimin e pozicionit negociues të Serbisë dhe zgjerimin e



mundësive diplomatike në dëm të Kosovës. Pra, sa më shumë që Kosova do t'i rezistojë një marrëveshjeje që do t'i përshtatej Serbisë, aq më shumë Serbia do ta vazhdojë fushatën agresive kundër njohjes së Kosovës dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Prandaj, Kosova nuk duhet injoruar dhe mohuar çështjen e çnjohjeve.

Në të kundërtën, duhet ta kushtëzojë heqjen e taksës në shkëmbim të ndërprerjes dhe kthimit të çnjohjeve, si dhe largimin e të gjithave barrierave jotarifore që Serbia ia ka vënë Kosovës në dekadën e fundit", ka deklaruar Visoka.

Kurse zëvendësministri i Jashtëm në dorëheqje, Anton Berisha, konsideron se mosarritja e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk ka ndikuar që shtete të caktuar ta vënë në dyshim njohjen e Kosovës. Ai thotë se Serbia po ndikon te shtete të caktuar duke prezantuar jo drejt qëllimin e dialogut. "Unë mendoj se rrëshqitja e bisedimeve në temat që kanë rrëshqitur, ka

krijuar një paqartësi në arenën ndërkombëtare, sidomos në disa shtete që janë jashtë zonave të Evropës. Serbia ka qenë aktive, në kuptimin kinse bisedohet për statusin e Kosovës dhe jo normalizim të raporteve", ka thënë Berisha.

Por, përveç efekteve të "ryshfetit", siç e cilëson Qeveria e Kosovës, theksohen edhe dobësi të tjera përbrenda diplomacisë kosovare që kanë ndihmuar apo ndikuar te disa vende që të marrin në konsideratë apo edhe të tërheqin njohjen e Kosovës si shtet.

Profesori Gëzim Visoka ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se beteja për njohje diplomatike është një fushë që ndërlihet faktorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë. Sipas tij, janë disa faktorë që janë duke mundësuar rritjen e çnjohjes së Kosovës. "Faktori i parë ka të bëjë me lënien anash të fushatës për njohjen nga dy qeveritë e kaluara të Kosovës. Përqendrimi është vënë në disa anëtarësime në organizata ndërkombëtare dhe kultivimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve

bilaterale me vendet që na kanë njohur, disi është lënë anash. Për më shumë, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe mungesa e qëndrimeve unike për interesat e brendshme dhe jashtme të Kosovës, ka ndikuar në zbehjen e prezencës ndërkombëtare të Kosovës", ka deklaruar Visoka. Faktori i dytë, sipas tij, ka të bëjë me zbehjen e interesimit dhe fuqisë ndikuese të vendeve, që në terminologjinë politike në Prishtinë, njihen edhe si shtete mike të Kosovës. "Kosova më nuk është prioritet ndërkombëtar dhe miqve të Kosovës u ka rënë ndikimi në disa rajone të botës, nga ku çnjohjet janë duke ardhur. Faktori i tretë, i ndërlihet me këtë të fundit, ka të bëjë me fuqizimin e ndikimit rus, dhe si pasojë, edhe të Serbisë, ku janë duke përdorur diplomacinë personale, ekonomike dhe ushtarake për ta shtyrë përpara çnjohjen e Kosovës", është shprehur Visoka. Sipas tij, është edhe një faktor tjetër që ka të bëjë edhe me gjendjen në vendet që e kanë njohur

Kosovën dhe si pasojë e ndërimit të qeverive dhe ndryshimit të interesave të tyre ndërkombëtare, këto vende pa hezitim e kanë ndryshuar qëndrimin për Kosovën.

Ndërkohë zëvendësministri i Jashtëm, Anton Berisha, ka thënë se autoritetet në Serbi janë duke e shfrytëzuar gjendjen politike në Kosovës dhe mungesën e një qeverie aktive për të lobuar kundër njohjeve të Kosovës. "Ne jemi qeveri në dorëheqje edhe ashtu nuk ka pasur ndonjë aktivitet, ndonëse vetë ministri ka qëndruar gjatë në Afrikë, nuk kemi parë ndonjë rezultat dhe presim që sa më parë të mbahen zgjedhjet dhe qeveria e re të jetë aktive, kurse Ministria e Jashtme duhet të kalojë në një fazë ofensive", ka thënë Berisha.

Zyrtarët në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës nuk kanë deklaruar se sa është aktualisht numri i shteteve që e kanë njohur deri tash Kosovën shtet. Por, në uebfaqen ministrit të Jashtëm Behgjet Pacolli, figuronë 116 shtete të cilat thuhet se kanë njohur Kosovën.

Vetëvendosja mban zgjedhjet e brendshme për kandidatë për deputetë

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Në përputhje me statutin e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të Brendshme, Komisioni Zgjedhor i Përgjithshëm i LV-së ka shpallur zgjedhjet e brendshme për kandidatët për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2019. "Të gjithë anëtarët e

Lëvizjes, të interesuar për të kandiduar në këto zgjedhje, duhet ta paraqesin deklaratën e kandidatit me dokumentacionin shoqëruar brenda 48 orëve nga publikimi i këtij njoftimi. Në secilën qendër të Lëvizjes Vetëvendosje janë ngritur Komisionet Zgjedhore ad hoc të Qendrave, ku anëtarët e intere-

suar mund të drejtohen për çdo informacion të mëtejshëm. Me besimin e plotë në vlerat e demokracisë sonë të brendshme, ky proces synon t'i çojë përpara kandidatët dhe kandidatët më të përgatitur për fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje", është thënë në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.



Përfundon me sukses cikli i investimeve kapitale në remontet e blloqeve të KEK-ut



PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka filluar remontet kapitale në blloqet e Termocentralit A dhe B. "Ashtu siç kemi njoftuar edhe më parë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka filluar me kohë remontet kapitale në blloqet e TC-A-së dhe TC-B-së, në mënyrë që para sezonit dimëror t'i kemi të gjitha

blloqet në dispozicion të prodhimit të energjisë elektrike. Prandaj, ashtu siç edhe kemi premtuar, tani jemi në fazën përfundimtare të investimeve kapitale në remontet e planifikuara", është thënë në njoftimin e KEK-ut.

Sipas këtij njoftimi, në këtë vazhde, TC-Kosova B ditë më parë ka përfunduar me sukses

remontin kapital në njësinë B-2 dhe pas përfundimit të fazës testuese kjo njësi ka filluar prodhimin me kapacitet të plotë. "Remonti kapital ka përfunduar me sukses edhe në njësinë A-3 të TC-Kosovës A dhe sot ka filluar faza testuese treditore. Për më tepër, për të pasur një siguri që gjatë sezonit dimëror të gjitha njësitë të jenë në prodhim me

kapacitete të plota, sipas planifikimit (të shtunën) ka filluar edhe revizioni disaditor i njësisë B-1 të TC-Kosova B", është theksuar në këtë njoftim. Më tutje, theksohet se objektivat e menaxhmentit të KEK-ut, që siguria e prodhimit në të gjitha njësitë të arrijë në nivelin më të lartë të mundshëm, ka arritur të përfundojë me sukses. "Për këto

arritje, menaxhmenti i KEK-ut falënderon të gjithë punëtorët e KEK-ut për angazhimin maksimal të treguar tash e disa muaj dhe njofton qytetarët e vendit se KEK-u me kohë ka marrë të gjitha masat e nevojshme që të ofrojë stabilitet energjetik në vend edhe gjatë sezonit dimëror", është thënë në njoftimin e KEK-ut.

Aeroporti 'Adem Jashari' thyen rekord të ri, në muajin gusht mbi 300 mijë udhëtarë



PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Aeroporti "Adem Jashari" ka thyer një rekord të ri. Vetëm gjatë muajit gusht në Aeroportin e Prishtinës janë regjistruar mbi 300 mijë udhëtarë, ndërsa janë realizuar 2 212 fluturime. Kështu ka njoftuar menaxheri i planifikimit të fluturimeve në Aeroportin "Adem Jashari", Driton Hyseni, i cili ka thënë

se në raport me gushtin e vitit 2018, rritja në fluturime është 16 për qind, ndërsa në udhëtarë 10 për qind. "Mbi 300 mijë udhëtarë (302 131) të shërbyer vetëm gjatë muajit gusht, ndërsa janë realizuar 2 212 fluturime. Në raport me gushtin e vitit 2018, rritja në fluturime është 16 për qind e në udhëtarë 10 për qind. Shifra prej 300 mijë udhë-

tarëve paraqet rekordin e Aeroportit sa i takon numrit të udhëtarëve të shërbyer në interval kohor brenda një muaji kalendarik, gjithashtu numri prej më shumë se 2 200 fluturimesh është numri më i madh i fluturimeve të realizuara ndonjëherë për një muaj", ka shkruar Driton Hyseni në llogarinë e vet në "Facebook".

Proceset e shpeshta zgjedhore kanë frenuar proceset ekonomike

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se ciklet e shpeshta zgjedhore në Kosovë kanë frenuar proceset ekonomike për krijimin e një ambienti më të mirë afarist në Kosovë. Sipas tij, janë penguar dhe po pengohen shumë projekte të rëndësishme

të cilat do të ndihmonin zhvillimin ekonomik të vendit. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Zeka ka thënë se Kosova po përballet me ikjen e të rinjve nga vendi në mungesë të vendeve të punës dhe mungesës së perspektivës, ndërkohë që institucionet e vendit nuk kanë bërë pothuajse

asgjë për ndaljen e tyre. Ai ka shtuar se bizneset po përballet me mungesë të punëtorëve, gjë që po pengon zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese në vend. Zeka ka theksuar se nga universitetet e Kosovës po dalin studentë të papërgatitur për tregun e punës.



Përgjysmohet sipërfaqja e tokës së mbjellë me grurë



Për tetë vjet (2012-2019) në Kosovë sipërfaqja e tokës e mbjellë me grurë është përgjysmuar apo është 52 mijë hektarë më pak. Ekspertë të bujqësisë dhe përfaqësues të bujqve në Kosovë vazhdimisht kanë tërhequr vërejtjen se tkurrja e tokës bujqësore po ndodh për shkak të ndryshimit të destinimit, duke e përdorur tokën bujqësore për veprimtarinë e ndërtimit

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Në Kosovë sipërfaqet e përgjithshme të tokës bujqësore të kultivuara me drithëra, konkretisht me kulturën e grurit, nga viti në vit po zvogëlohen, duke ulur kështu edhe sasinë e prodhuar të këtij produkti në vend. Sipas shifrave zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2012, më shumë se 102 mijë hektarë sipërfaqe kanë qenë të mbjella me grurë, në vitin 2017, kjo sipërfaqe ka rënë në 80 mijë hektarë. Ndërkaq, vitin e kaluar 74 mijë hektarë sipërfaqe kanë qenë të kultivuara me kulturë të grurit, kurse gjatë këtij viti janë mbjellë vetëm 50 mijë hektarë sipërfaqe me grurë.

Në një llogaritje të thjeshtë i bie që për tetë vjet (2012-2019) në Kosovë sipërfaqja e tokës e mbjellë me grurë është përgjysmuar apo është 52 mijë hektarë më pak.

Ekspertë të bujqësisë dhe përfaqësues të bujqve në Kosovë vazhdimisht kanë tërhequr vërejtjen se tkurrja e tokës bujqësore po ndodh për shkak të ndryshimit të destinimit, duke e përdorur tokën bujqësore për veprimtarinë e ndërtimit. Kjo, sipas tyre, në të ardhmen do të sjellë pasoja dhe mungesë të sigurimit të produkteve elementare bujqësore. Jusuf Cikaqi, drejtor në Departamentin për Politika Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, ka theksuar se te kulturat njëvjeçare, sipërfaqja ndryshon nga viti në vit.

Ai thotë se çmimi dhe kërkesa në treg janë ndër faktorët që ndikojnë në mbjelljen e tokës me kultura njëvjeçare. "Sa i përket vitit të kaluar, ku sipërfaqja me të mbjella ka qenë 74 mijë hektarë, sivjet ka rënë në 50 mijë hektarë. Faktorë kryesorë kanë qenë kushtet klimatike, sepse ka pasur

thatësi në vjeshtën e vitit 2018 dhe fermerët, pavarësisht prej planifikimeve që kishin për mbjellje të 75 deri në 80 mijë hektarëve, nuk kanë arritur të mbjellin për shkak të thatësisë. Edhe kjo sasi e grurit që është mbjellë dhe është korrur tani, është mbjellë në muajin dhjetor pas afatit optimal", ka theksuar Cikaqi për "Radion Evropa e Lirë".

Por, kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve, Tahir Tahiri, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se disa nga arsyt e zvogëlimit të hapësirës së mbjellë me drithëra janë ndërtimet e shumta në tokat bujqësore, pastaj politikat joadekuate për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, migrimi dhe çmimi jo i leverdishëm i grurit për fermerët. "Arsyeja e parë është mungesa e perspektivës. Kjo mungesë e perspektivës ka bërë që një numër i madh i të rinjve

që janë marrë sidomos me bujqësi, kanë migruar jashtë Kosovës. Arsyeja tjetër është se prodhimet e grurit e kanë një konkurrencë të tmerrshme jolegale nga importi. Gruri nga vendet e rajonit në Kosovë hyn me çmim më të lirë sesa prodhimi vendor. Sidomos nga shteti i Serbisë (para vendosjes së taksës), pasi mullisët në Kosovë janë furnizuar me grurë nga rezervat shtetërore që nuk është i dedikuar për ushqim të njerëzve", ka thënë Tahiri.

Ish-ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, thotë se arsyeja e zvogëlimit të sipërfaqes së tokës së kultivuar me grurë paraqitet për shkak të çmimit të lartë të mekanizimit bujqësor. "Kostoja e madhe e shpenzimeve për mbjelljen e grurit, mekanizmi bujqësor, farërat, plehrat, të gjitha importohen dhe kanë një kosto të lartë. Pastaj, besoj se edhe çmimi i grurit nuk jep shumë fitime. Më pas edhe subvencionet e shtetit duhet të rriten, edhe pse tashmë Qeveria e Kosovës ka lëvizur në këtë drejtim, por besoj se kjo ndikon shumë. Arsyeja tjetër paraqitet për shkak të sipërfaqeve të vogla të tokës, ku shumica e fermerëve kanë hapësira të vogla të tokës", ka thënë

Vehapi.

Për ta rritur interesimin e fermerëve për mbjelljen e sipërfaqeve më të mëdha me grurë, Ministria e Bujqësisë ka disa vjet që subvencionon fermerët me nga 150 euro në vit, kurse sipërfaqja minimale e mbjellë me grurë duhet të jetë 2 hektarë në pronësi të fermerit. Sidoqoftë, në gjithë territorin e Kosovës para një muaji ka përfunduar fushata e korrje-shirjeve. Derisa zyrtarë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pohojnë se sivjet Kosova plotëson deri në 50 për qind nevojat për ushqim nga rendimentet e grurit, përfaqësues të bujqve vlerësojnë se kjo shifër nuk arrin as 30 për qind të mbulimit të nevojave.

Nga këto sipërfaqe prodhimi i përgjithshëm vendor gjatë viteve të fundit, sipas të dhënave zyrtare, ka mbuluar deri në 60 për qind të nevojave vendore për konsum dhe pjesa është mbuluar nga importi. Në një raport të Ministrisë së Bujqësisë, të quajtur "Raporti i Gjellbër 2018", thuhet se në Kosovë për kokë banori janë prodhuar 127 kilogramë miell. Vlera e prodhimit të grurit në vitin 2017 ishte 51 milionë euro.

Nis faza e dytë e dezinfektimit në Podujevë

PODUJEVË, 1 SHTATOR (ER) - Të dielën ka filluar faza e dytë e dezinfektimit të hapësirave publike në Podujevë. Dezinfektimi ka filluar të kryhet përgjatë rrugës kryesore të qytetit "Zahir Pajaziti", në parkun e qytetit dhe në "Parkun e Paqes". Kjo komunë ka bërë me dije se dezinfektimi i

hapësirave të jashtme bëhet me qëllim të eliminimit të insekteve të dëmshme si masë parandaluese e përhapjes së sëmundjeve infektive. Me këtë rast, Komuna e Podujevës ka njoftuar shoqatat e bletarëve dhe pronarët e bletëve që t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm që parashihen në këto raste.

"Lusim edhe qytetarët që t'i mbyllin dritaret gjatë kohës së dezinfektimit të hapësirave të jashtme të qytetit, në mënyrë që ta parandalojnë hyrjen e insekteve (mushkonjave dhe insekteve të tjera) nëpër banesat apo shtëpitë e tyre", është thënë në njoftimin e Komunës së Podujevës.



Haziri pret në takim kryengritësin për të drejtat e shqiptarëve, Ibrahim Arifin

GJILAN, 1 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të dielën në takim veprimtarin dhe kryengritësin për të drejtat e shqiptarëve, Ibrahim Arifin. Haziri e ka falënderuar Arifin për kontributin 60-vjeçar dhe të familjes Arifi në mënyrë që shqiptarët të jetojnë të lirë dhe të bashkuar.

Kreu i Gjilanit ka thënë se është rast unik që babai e merr pushkën e djalit të vvarë dhe i bashkohet luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, siç ka

ndodhur me nipin e tij, Skifter Arifi, i cili ra dëshmor dhe luftën e vazhdoi babai i tij, veprimtari i madh Milazimi.

Ndërkaq veprimtari për çështjen kombëtare, Ibrahim Arifi, e ka falënderuar kryetarin Lutfi Haziri për pritjen, kontributin e tij për lirinë e shqiptarëve dhe vlerësimin, nderimin dhe kujdesin e përhershëm që ka pasur për familjen Arifi dhe për figurën e kolosit të shqiptarëve, Idriz Seferi. Në fund, veprimtari Arifi ia dhuroi kryetarit Haziri librin e tij "Kujtime jete".



Miratohet rregullorja e repër varrezat në Ferizaj

FERIZAJ, 1 SHTATOR (ER) - Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka marrë një sërë vendimesh në dobi të jetës së qytetarëve. Pas diskutimeve publike dhe propozimeve nga komunitetet fetare dhe qytetarëve, u vendos që të miratohet rregullorja e re për varrezat, shërbimet e varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kjo pikë e diskutimit u shoqërua me komente dhe debate për gjendjen aktuale të varrezave të reja të qytetit, por në fund u miratua si e plotë për t'u zbatuar.

Me shumë diskutime u përcoll edhe një pikë e rendit të ditës e cila ka të bëjë me hartimin e një rregulloreje të re e cila do të vihet në diskutim publik dhe ka për qëllim të vë rend e rregull në qytet edhe për vendosjen e përkohshme të objekteve nëpër hapësirat publike.

Drejtori për Urbanizëm dhe Mjedis, Lulzim Aliu, ka pohuar se pret komente dhe propozime për ta bërë një rregullore sa më



funktionale, ndërsa deputetët dhanë propozimet që duhet të

inkorporohen në këtë rregullore. Arian Imeri, shef i grupit parla-

mentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka thënë se kjo rregul-

lore ka qenë më se e domosdoshme që të bëhet në mënyrë që të krijohet një rend për hapësirat publike që jepen në shfrytëzim.

Ndërkaq Imri Hashani nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë për që kjo rregullore të dalë në diskutim publik, por ka thënë se pas miratimit të saj të respektohet dhe të punohet në bazë të kësaj rregullore.

Pas diskutimeve për vendosje të objekteve të përkohshme në hapësirat publike dhe menaxhimin e këtyre hapësirave, u vendos që ky draft dokument të dalë në diskutim publik. Ndërkaq gjatë punimeve të mbledhjes u miratua edhe Rregullorja Komunale për Transparencë. Kurse drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, para të pranishmeve ka prezantuar raportin financiar janar-qershor 2019, ku anëtarët e Kuvendit kanë diskutuar në pika të shkurtra në lidhje me këtë raport.

Asfaltohet rruga "Kosharja" në Suharekë

SUHAREKË, 1 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se është asfaltuar rruga "Kosharja" në këtë komunë, e

cila lidh fshatin Gelancë me rrugën kryesore Suharekë - Prizren. Muharremaj, i cili ka inspektuar punimet në asfaltimin e kësaj rruge, ka thënë se

zhvillimi i infrastrukturës do të vazhdojë në të gjithë territorin e Suharekës. "Sot u bë asfaltimi i rrugës 'Kosharja', e cila do ta lidhë fshatin Gelancë me rrugën

kryesore Suharekë - Prizren. Zhvillimi i infrastrukturës vazhdon në gjithë territorin e Komunës së Suharekës", ka thënë Muharremaj.



Plani për ta zgjeruar Rusinë



Nga Janusz BUGAJSKI

Kremlini po përgatitet ta zgjerojë federatën ruse për t'i mundësuar presidentit Vladimir Putin të qëndrojë në pushtet. Një pasardhës i përgatitur presidencial i Putinit nuk ekziston dhe frika se pa të vendi mund të frakturohet po rritet në mesin e elitës së Rusisë.

Për ta ruajtur fasadën e legjitimitetit, Rusia operon me një kushtetutë demokratike, sipas së cilës, presidenti është i kufizuar me tre mandate të një-pasnjëshme. Me mbarimin e mandatit (të tretë) të Putinit në 2024-n, zyrtarët po përllogarisin se si ta ndryshojnë kushtetutën, madje edhe t'i forcojnë fuqitë presidenciale.

Një prej mundësive është krijimi i një shteti të ri, me Putinin në krye. Lëvizja më e kuptueshme do të ishte bashkimi i Rusisë dhe Bjellorusisë dhe shpallja e një federatë e re. Sidoqoftë, meqë

qeveria bjelloruse do t'i bënte rezistencë një pushtimi të tillë, ku dhe konfliktet e armatosura janë të mundshëm, Moska mund të përipiqet të shmangë një luftë tjetër.

Një tjetër mundësi e arritshme, e cila mund t'i kufizojë veprimtaritë e shtuara ushtarake, do të ishte zgjerimi i federatës ruse thjesht duke përvetësuar territoret e shteteve fqinje që Moska tashmë kontrollon. Zyrtarët, në vijim, mund të pretendonin se me një Rusi më të madhe duhet të miratohet një kushtetutë e re, e cila do ta zgjaste presidencën e Putinit për tre mandate të tjerë, madje do t'i zgjeronte fuqitë e tij ekzekutive.

Nëpërmjet zgjerimit të Rusisë, Putini do të përipiqej ta largonte vëmendjen e qytetarëve nga dështimet e tij ekonomike, pa një ndërhyrje të re të kushtueshme ushtarake. Nga kjo ai mund të përfitojë mbështetje publike, veçanërisht nga ata rusë që këmbëngulin në kompleksin perandorak, sipas të cilit, madhësia është e barabartë me forcën. Nëse protestat kundër politikave të qeverisë zmadhohen, zgjerimi do t'i jepte Putinit mundësinë për të vënë në fuqi dekretet e gjendjes së jashtëzakonshme, me pretendimin se

fuqitë e huaja armiqësore po kërkojnë të copëtojnë Rusinë.

Kremlini tashmë kontrollon disa territore, qeveritë separatiste të cilave mund të bëjnë kërkesë (zyrtare) për përfshirje brenda Rusisë, pas mbajtjes së referendumave të rreme. Duke pretenduar se popullsitë e rajoneve tashmë të ndara, kanë shprehur dëshirën për t'u bashkuar me Rusinë, Moska do ta shmangte provokimin e një konfrontimi të drejtpërdrejtë me NATO-n, edhe nëse veprimet e saj dënohen nga fuqitë perëndimore.

Zgjerimi përmes përfshirjes së territoreve kufitare do të përqendrohej në tre shtete - Gjeorgji, Ukrainë dhe Moldavi. Moska tashmë ka krijuar një prani të madhe ushtarake në të gjitha rajonet e pushtuara në mënyrë që të parandalojë çdo përpjekje të qeverive gjeorgjiane, ukrainase dhe moldave për t'i rimarrë territoret e tyre.

Pas luftës së gushtit të 2008-s, në Gjeorgji, Rusia kontrollon dy rajone secesioniste (në favor të shkëputjes nga territori i shtetit). Zgjidhja më e evidente për Kremlinin do të ishte ta bashkonte zyrtarisht Osetinë e Jugut të Gjeorgjisë me Osetinë e Veriut, e cila është një njësi federale e Federatës Ruse. Një

veprim i tillë ka të ngjarë të mbështetet nga shumica e osetëve që kanë kundërshtuar ndarjen e tyre për dekada.

Rajoni i Abhazisë përgjatë bregut të Detit të Zi konsiderohet me rëndësi strategjike për dominimin e Rusisë në Kaukazin e Jugut. Përfshirja e Abhazisë në Rusi mund të hasë në më shumë rezistencë nga populli, i cili do të preferonte pavarësi të plotë. Sidoqoftë, rajoni është militarizuar thellësisht nga Moska dhe forcat vendëse të sigurisë janë plotësisht nën kontrollin rus, duke reduktuar kështu shanset e një rezistence efektive.

Në Moldavi, kontrolli rus mbi rajonin e Transnistrisë mund të bëhet zyrtar nëpërmjet marrjes së plotë (të tij). Kjo do t'i jepte Moskës një kufi të gjatë perëndimor me Ukrainën, ku prania e saj ushtarake mund të përforcohet për të kërcënuar dhe larguar forcat e Kievit nga rimarrja e territoreve të okupuara në lindje të vendit. Në mënyrë të ngjashme me Kaliningradin në Detin Balltik, duke kontrolluar drejtpërdrejt Transnistrinë, Rusia do të fitonte një rrugë dalje në lumin Danub.

Në Ukrainë, Moska mund të mbajë referendume në territoret

e marra tashmë nga aleatët e saj në rajonet Donetsk dhe Luhansk. Këto territore mund të merren si dy njësi ose si një rajon federal Donbas brenda Rusisë. Kremlini do ta llogariste që pas një periudhe zemërimi perëndimor, kundërshtimi ndërkombëtar do të binte, pasi vëmendja do të shkonte te ndonjë krizë tjetër rajonale.

Duke marrë parasysh se sanksionet ekonomike perëndimore që erdhën si ndëshkim për kapjen e Krimesë nga Rusia nuk duket se do të hiqen së shpejti, Moska mund të arrijë në konkluzionin se ka pak për të humbur në (rastin e) një ofensive të re gjeopolitike. Mund të përlogaritet se një marrje (territoresh) në shumë fronte do ta bashkonte popullin rus në një akt patriotizmi historik dhe në një kundërshtim të presionit perëndimor.

Strategjia e zgjerimit mund të jetë një nga kartat e fundit të Putinit për ta vulosur trashëgiminë e tij si një udhëheqës i madh që konsolidoi tokat ruse. Pasi ka mbajtur tashmë për njëzet vjet zyrën më të lartë, ndryshimet kushtetuese do të garantonin që Putini t'ia kalojë edhe Stalinit për jetëgjatësinë e sundimit të tij.

(Marrë nga Dita)

Për sa unitet dhe sa diversitet ka nevojë Evropa?



Boris KALNOKY

Ka pasur një kohë, kur shtroheshin më shumë çështje teknike, kur vinte fjala për Evropën. Male me gjalpë dhe liqene me qumësht u krijuan kështu me subvencionet agrare të BE-së, por që duhej të reduktoheshin pastaj po falë subvencioneve të tjera, vetëm që të mos prodhohej kaq shumë gjalpë dhe qumësht. Kush e kuptonte këtë? As nuk e vriste njeri mendjen ta kuptonte, sepse këtë vramendje ua linte teknokratëve të BE-së.

Kur Evropa u bë me kufij të jashtëm dhe me një monedhë të përbashkët situata ndryshoi. Me këtë politizimi dhe toni helmues. Sepse kufijtë dhe paraja janë ato që e përbëjnë shtetin. Në fillim nuk i kuptoi kush aq mirë pasojat kaq revolucionare të këtyre zhvillimeve. Pra që një konstrukt transnacional të merrte përsipër funksione, që deri më atëherë ishin thelbi i shteteve kombëtare.

Atyre u mbeti si perspektivë në të ardhmen, vetëm pak më shumë, se roli i një administrimi province në kuadër të një konstrukt më të madh politik.

Për shkak se ky zhvillim nuk u tematizua si duhej dhe nuk u diskutua plotësisht në diskursin shoqëror, qytetarët nuk e tretën mirë. Me kalimin e kohës shumë vetë e kuptuan, oh këtu paska ndryshuar diçka shumë e madhe...

Ata vazhduan t'i zgjedhin qeveritë e tyre, por këto qeveri dhe me këtë edhe zgjedhësit kishin gjithnjë e më pak hapësirë vepruese për ta farkëtuar vetë fatin e tyre si shoqëri. Bashkim Evropian do të thoshte pra, kështu e ndjen shumë vetë, më pak vetëvendosje.

Pushteti transnacional përballë shtetit kombëtar

Momentet më shokuese madje janë të datuara: Kriza e euros nga viti 2009 u tregoi grekëve, se ata nuk kishin asnjë rrugë tjetër të dilnin nga gjendja e vështirë, veç asaj që u tregoi Evropa. Ndërsa kriza e refugjatëve e vitit 2015 u tregoi shoqërive, që nuk donin emigrantë, që më të fortët në BE kishin vullnetin, që "me vendim

shumice" të detyronin vendet rezistuese me kuota shpërndarjeje të refugjatëve.

Kjo përpjekje e ushtrimit të pushtetit transnacional kundër vullnetit të parlamenteve kombëtare dhe zgjedhësve të tyre, u kthye në zile zgjimi në BE për të gjithë ata, që donin ta përcaktonin vetë rrugën e vendeve të tyre edhe më tej. E ata jemi kryesisht ne në Lindje të Evropës. Ne e shijojmë lirinë tonë si shoqëri, nga ana historike një kohë e shkurtër, që kur e shkundëm nga vetja konstruktin transnacional "blloku lindor" para 30 vjetësh. E këtë liri, që të vendosësh vetë për vendin tënd nuk duam ta dorëzojmë kollaj.

Rezistenca e Hungarisë dhe vendeve të tjera në rajon tregoi pastaj edhe kufijtë e "integritit" në Evropë. Evropa nuk është vërtet "Bashkim" dhe kuota e refugjatëve dështoi.

Për sa unitet transnacional, për sa liri kombëtare ka nevojë BE, me qëllim që të mos shpërbëhet, por që t'u lerë hapësirë lirie edhe shoqërive anëtare?

Ka detyrime, që kërkojnë unitet, ndryshe puna nuk funksionon. Monedha e përbashkët euro, p.sh. Kush e ka këtë valutë nuk mund të bëjë më politikën e vet monetare. Që t'i futesh projektit

euro, kërkon pjekuri, ndryshe pasojat mund të jenë katastrofale. Kjo vlen edhe për kufijtë e jashtëm. Kush nuk e kupton, se me një politikë të papërgjegjshme buxhetore dhe një mbrojtje kufitare të dobët nuk rrezikon vetëm vendin e vet, por trondit të gjithë BE-në, ai duhet të mësojë ose të dalë nga zona Shengen apo eurozona.

BE-ja të mos marrë më funksione të rëndësishme të shteteve kombëtare

Aktualisht është bërë e qartë, që ky proces i nxjerrjes mësim nuk ka përfunduar. Pasoja logjike: BE-ja nuk duhet të vazhdojë më tej të marrë përsipër funksione të tjera të rëndësishme të shteteve kombëtare pa i sqaruar efektet e tyre mirë në diskursin shoqëror. Një sigurim i përbashkët papunësie, një pagë minimale evropiane, tatime evropiane, një ushtri evropiane me betim besnikërie në flamurin blu, vendimet e shumicës, ku aleancat e vendeve të forta mundin ato të dobëtat, pa pranueshmërinë në shoqëri të disa efekteve negative për vende të caktuara çojnë në hapa radikalë e, ndoshta, në një çast edhe në shpërthime politike. Pasoja do të ishte një dobësim e jo

forcim i Evropës.

"Unitet në diversitet", kjo është motoja e BE-së, por në luftën politike harrohet se me "diversitet" kuptohen shtetet kombëtare. Nacionet si "kombëtar" apo "shtet kombëtar" nga përkrahësit e një Evrope më fort të integruar përdoren gati si fjalë ofenduese. Shumëllojshmëria e shteteve kombëtare në retorikën e Brukselit duhet të futet më shumë respekt për to. Shteti kombëtar është një kuadër, ku demokracia mund të funksionojë më së miri. Historikisht BE-ja lidhet me mirëqenien, madje ajo kështu filloi, si union ekonomik. Ajo që dëgjohej shpesh, se BE-ja qëndron për solidaritet dhe demokraci, kurse shteti kombëtar për nacionalizmin është një marrëzi ideologjike. BE-ja është tregu, ku shtetet anëtare demokratike, në bazë të rregullave të përbashkëta, përfaqësojnë interesat e tyre dhe bëjnë pazare politike, pra bëjnë kompromise. Por për interesat e tyre kombëtare luftojnë të gjithë, gjithmonë, pa u përkulur. E kjo nuk është ndonjë gjë e keqe. Sepse ato janë interesat e qytetarëve, votuesve të tyre. Kjo është demokracia!

(Boris Kalnoky, korrespondent nga Hungaria për gazetën gjermane "Die Welt" dhe media të tjera gjermane)

Protestuesit në Hong Kong bllokojnë rrugët që çojnë për në aeroport

HONG-KONG, 1 SHTATOR - Mijëra protestues të dielën kanë bllokuar rrugë dhe rrjetin e transportit publik që çojnë drejt aeroportit të Hong Kongut, një përpjekje kjo për të tërhequr vëmendjen për luftën e tyre për më shumë demokraci për qytetin e udhëhequr nga Kina, që po përballlet me krizën më të madhe politike në dekada. Dhjetëra fluturime raportohet

se janë anuluar të dielën, teksa aktivistët kanë bllokuar rrugët që çojnë për në aeroport. Protesta vjen disa orë pasi protestuesit dhe policia u përleshën në qendër të Hong Kongut, ku disa protestues ndezën zjarre dhe hodhën koktejl molotovi dhe policia përdori gaz lotsjellës dhe topa uji ndaj protestuesve. Protestat në Hong Kong kanë nisur 12 javë më parë, fillimisht

për të kundërshtuar një ligj të ekstradimit. Qeveria në Hong Kong ka njoftuar më pas se ka hequr dorë nga ligji që do të lejonte që kriminelët e dyshuar të mund të ekstradoheshin në Kinë. Por, protestuesit kanë zgjeruar kërkesat e tyre, duke kërkuar një hetim të pavarur dhe demokratik mbi brutalitetin e dyshuar të përdorur nga policia ndaj protestuesve.



80-vjetori i nisjes së Luftës së Dytë Botërore, Gjermania i kërkon falje Polonisë

Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, i ka kërkuar falje Polonisë për konfliktin më të përgjakshëm të historisë, gjatë një ceremonie në qytetin Wielun, ku bombat e para ishin hedhur gjatë Luftës së Dytë Botërore, 80 vjet më parë, ku rreth gjashtë milionë polakë, përfshirë tre milionë polakë hebrenj, vdiqën gjatë konfliktit që mori jetën e mbi 50 milionë njerëzish



VARSHAVË, 1 SHTATOR - Gjermania i kërkon falje Polonisë për krimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore. Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, i ka kërkuar falje Polonisë, për konfliktin më të përgjakshëm të historisë, gjatë një ceremonie në qytetin Wielun, ku bombat e para ishin hedhur gjatë Luftës së Dytë Botërore, 80 vjet më parë. "Përkulem para viktimave të sulmit në Wielun. Përkulem para viktimave polake të

tiranisë gjermane dhe kërkoj falje nga ju", tha Steinmeier të dielën, teksa iu adresua të pranishmëve në gjuhën gjermane dhe atë polake. Steinmeier foli përkrash homologut të tij polak, Andrezej Duda, i cili denoncoi sulmin e Gjermanisë naziste kundër Polonisë, të cilën e cilësoi si "akt barbar". "Ne nuk mund ta harrojmë Luftën e Dytë Botërore dhe kur dëshmitarët e asaj ngjarje nuk janë më, në mënyrë që të sigurohemi që ajo që

ndodhi në Wielun dhe më vonë edhe në shumë vende të tjera të Polonisë dhe jashtë saj, që të mos përsëriten kurrë", tha Duda. Rreth gjashtë milionë polakë, përfshirë tre milionë polakë hebrenj, vdiqën gjatë konfliktit që mori jetën e mbi 50 milionë njerëzish.

Steinmeier dhe krerë të tjerë shtetërorë po marrin pjesë në ceremonitë që po mbahen në Poloni, për të shënuar 80-vjetorin e nisjes së Luftës së Dytë Botërore. Ceremonitë filluan në qytetin e vogël Wielun, ku nisën bombardimet e para të luftës, më 1 shtator 1939, me fjalimet e pres-

identit polak Andrzej Duda dhe të homologut të tij gjerman, Frank-Walter Steinmeier.

Nënpresidenti amerikan Mike Pence vlerësoi guximin e popullit polak. "Askush nuk luftoi me më shumë guxim, vendosmëri dhe tërbim të justifikuar sesa polakët", tha Pence përpara krerëve të qeverive dhe shteteve pjesëmarrës në ceremoni, ku ishin edhe kancelarja gjermane Angela Merkel dhe kryeministri francez Edouard Philippe.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, anuloi pjesëmarrjen e tij në këto ceremoni, për shkak se tha se duhet të merret me përgatitjet, pasi Uragani i fuqishëm Dorian, pritët t'i afrohet Floridës.

Pushtimi i Polonisë nga Gjermania naziste më 1 shtator 1939 shënoi fillimin e Luftës së Dytë Botërore.

Netanyahu premton aneksimin e vendbanimeve në Rripin e Gazës

TEL-AVIV, 1 SHTATOR - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu deklaroi se do t'i aneksojë vendbanimet e hebrenjve në territoret e pushtuara të Rripit të Gazës. Premtimi u bë gjatë inaugurimit të godinës së shkollës në një prej vendbanimeve e reja. Kryeministri Netanyahu foli gjatë ceremonisë së çeljes së një shkolle në vendbanimin Elkana, në Rripin e Gazës. "Kjo është toka jonë dhe ne do të ndërtojmë një Elkanë tjetër, dhe një tjetër, dhe një tjetër



pas saj. Nuk do të zhvendosim njerëz. A ka këtu fëmijë nga Gush Katif? Nuk do të ketë më raste si Gush Katif. Nuk do të ketë më shpërngulje. Me ndihmën e Zotit, do ta shtrijmë sovranitetin hebre në të gjitha vendbanimet, si pjesë e tokës së Izraelit, si pjesë e Shtetit të Izraelit", deklaroi kryeministri Netanyahu. Nuk është e qartë se kur do ta realizojë këtë premtime Netanyahu. Ai premtoi diçka të ngjashme në muajin prill, përpara zgjedhjeve të

përgjithshme, por nuk e vuri në jetë.

Këtë muaj, izraelitët shkojnë sërish drejt kutive të votimit.

Premtimet e Netanyahu për aneksim zënë vend mes votuesve të partive të së djathtës së ashpër, të cilët kundërshtojnë dorëzimin e tokës të palestinezët.

Çështja e vendbanimeve është ndër më të nxehtat, ndërsa vazhdojnë përpjekjet për rifillimin e bisedimeve të paqes Izrael-Palestinë, të ngrira që nga viti 2014.

Të shtënat në Teksas, të paktën pesë të vrarë

TEKSAS, 1 SHTATOR - Të paktën pesë janë vrarë dhe rreth 20 të tjerë janë plagosur, pas të shtënave në Teksas të Shteteve të Bashkuara. Fillimisht sulmuesi i armatosur ka shtënë në drejtëm të policisë, të cilët ndaluan makinën e tij, në mes të qyteteve Midland dhe Odessa. Ai më pas ishte larguar me makinën e tij dhe kishte hapur zjarr në drejtëm të personave të tjerë, në disa lokacione të ndryshme. Sulmuesi më pas është qëlluar

për vdekje nga policia. Ende nuk dihen motivet e sulmit, i cili u krye nga një person rreth të 30-tave. Në mesin e të plagosurve janë edhe tre zyrtarë policorë. Në Spitalin në Odessa, autoritetet thanë se një fëmijë 2 vjeç është në mesin e të plagosurve, ndërkaq, shtatë pacientë të tjerë janë në gjendje të rëndë. Lidhur me të shtënat në Teksas, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump tha

përmes një postimi në "Twitter", se ai po informohet për këtë ngjarje. Më vonë, nënpresidenti amerikan, Mike Pence tha se administrata Trump "vazhdon të jetë e përkushtuar që të punojë me të gjitha palët në Kongres, që të ndërmerren veprime për t'u përballur me mizori të tilla që po ndodhin në vendin tonë". Ky është incidenti i dytë në Teksas gjatë këtij muaji. Më herët gjatë këtij muaji, një person i armatosur, la të vdekur 20 persona.





JOHN KRASNIQI KËNGË PËR HEROIN E KOMBIT FEHMI LLADROVCI



Ismet SYLEJMANI

Në fshatin e lindjes të Udhëheqësit të madh e Gjeneralit të lavdishëm të UÇK-së, Heroit të Kombit Fehmi Lladrovci!
Në truallin e Vëllezërve Karaqica, aty ku unë për herë të parë në jetën time kam ngrënë bukë drenice në vitin 1983!
Në shtëpinë e mikut të nderuar Goni Karaqica, bashkë me kryetarin më të mirë të komu-

nave të Kosovës, Kryetarin e Komunës së Drenasit të nderuarin Ramiz Lladrovci dhe Sherif Gashin nga Vushtrria që jeton në Paris, duke dëgjuar këngë nga këngëtari i famshëm i Drenicës dhe i gjithë hapsirës shqiptare John Krasniqi!
Ishin çaste të paharruara, sepse në atë hapsirë të vogël kishte interesim të jashtëzakonshëm!
Dëgjohej duke knduar këngë-

tari i madh e shoku i ngushtë i Heroit të Kombit, të madhit Beqir Gashi!
Kjo mbrëmje ishte e veçantë sepse John Krasniqi ia komunikoi Kryetarit Lladrovci se e ka përgaditur një këngë për Heroin Fehmi Lladrovci dhe se ajo këngë do të jetë një nga këngët më të mira të jetës së tij e të fuqisë së tij profesionale prej këngëtari e rapsodi që nuk ka shqiptar e odë burrash, sallë

dasmash e koncertesh që nuk do të dëshironin ta kenë në mesin e tyre këtë artist të rrallë që është brumosur e është pjekur në kujdesin e vëllaut të tij këngëtar e rapsod i mirënjohur në Drenicë e gjithë hapsirën shqiptare Arben D.Krasniqi!
Ishte natë e paharruar!
Faleminderit Gonit që na bashkoi!
Shkabaj 30.08.2019!



E jashtëzakonshme

Varret misterioze 1600-vjeçare në formë vrime çelësi

Legjenda thotë se për t'i krijuar varret "kofun", ditën punonin njerëzit dhe natën perënditë. Të ngjashme për nga përdorimi me piramidat e Egjiptit, këto varre, të cilat kanë ekzistuar që 1600 vjet më parë nëpër Japoni, ishin një mënyrë për ta shprehur pushtetin e personit që varrosej brenda tyre.



Të mbrojtura nga UNESCO, shumë prej tyre nuk janë lejuar të hapen e të gërmohen nga arkeologët, ndaj mbeten një mister i madh.

FOTO E DITES



Një helikopter lëshon ujë mbi një kodër për ta shuar zjarrin në periferinë lindore të Athinës në Vironas. /AP/

E rrallë

Zbulohet breshka e detit me dy koka

Një breshkë e rrallë deti me dy koka është zbuluar në bregun e Hilton Head duke lënë ekspertët pa fjalë. Ajo bënte një jetë normale në ishullin e Karolinës së Jugut. Pavarësisht prej pamjes së

pazakontë, ekspertët thonë se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar sepse ky lloj anormaliteti është, në fakt, diçka normale. Menaxherja e breshkave të



ujit në ishull, Amber Kuehn, ka thënë se kafshët e tilla janë shumë të rralla.

BARSOLETA E DITËS



Vjehrra dhe nusja
Nusja duke e shikuar futbollin.
Hyn vjehrra dhe thotë: Eh dynja, dynja!
Nusja: Jo, oj nënë, hala janë zero-zero.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Një ditë shumë e bukur mbushur me ngjarje të reja. Do të keni një miksim të pasionit dhe xhentileses me partnerin.



DEMI

Hëna në shenjë nuk ju bën shumë miq të mirë sot. Megjithatë do të neutralizoni gjithçka gjatë pasdites në një ambient familjar.



BINJAKËT

Një ditë shumë me fat sa iu përket financave. Do të merrni lajme të mira kudo ku keni pasur ide për investime ose punë të reja.



GAFORRJA

Do t'ju duken më të lehta problemet e ditës falë pranisë së Hënës në shenjë tuaj. Me kursimet do të jeni shumë i kënaqur sot.



LUANI

Megjithëse sot ndiheni në qendër të vëmendjes, mos mendoni se bota rrotullohet rreth jush.



VI RGJËRESHA

Ditë e qetë kjo e sotmja dhe ju po ndiheni mjaft mirë me këtë qetësi. Në fund të fundit, pak pushim nuk mund t'ju bëjë veçse mirë.



PESHORJA

Me optimizmin dhe dashurinë tuaj arrini të përçoni mjaft energji pozitive të të tjerët. Dita sot paraqitet e këndshme.



AKREPI

Një ditë shumë e lodhshme si nga aktivitetet dhe nga njerëzit që ju rrethojnë. Do t'ju duhet të përballeni vetë me pjesën më të madhe të gjërave.



SHIGJETARI

Me tre planetë në shenjë tuaj sot, bëhuni gati ta fitoni lotarinë. Është një ditë mjaft e favorshme për çdo investim.



BRICJAPI

Sot jeni të pakënaqur me disa situata që sapo i keni vënë re. Do të shkoni të ankoheni tek miku juaj më i mirë.



UJORI

Do të pëlqeni vende ku lëvrohet kultura dhe arti sot. Jeni shumë të dashuruar me kulinarinë e mirë dhe do ta kënaqni shpirtin dhe stomakun.



PESHQIT

Sot i gjithë fokusi juaj është i përqendruar te puna. Keni lënë pak pas dore partnerin, por do të rikuperoni në darkë.

Lindsay Lohan pritet të vijë me këngë të re



Aktorja e njohur Lindsay Lohan është duke u përgatitur që pas dhjetë vjetëve të publikojë një këngë. Lohan ka lëshuar në rrjete sociale

një pjesë të këngës. Sipas "Daily Mail", 33-vjeçares në video iu bashkua edhe miku i saj Alex Mugler, me të cilin vallëzoi nën shoqërimin e kësaj kënge.



A janë në lidhje Jamie Foxx dhe Sela Vave?



Aktori i njohur Jamie Foxx dhe këngëtarja e re Sela Vave gjatë gushtit janë parë disa herë të shoqëruar bashkë. Këtë herë, sipas "Daily Mail", ata ishin

bashkë në festivalin Malibu Chili Cook-Off. Foxx, po ashtu, me vete pati edhe vajzën e tij Annalise Bishop dhe dukeshin se po kalonin të lumtur të gjithë së bashku.

Rita Ora me koncerte tregon se bën vetëm katër orë gjumë

Këngëtarja e njohur nga Prishtina, Rita Ora, është shumë aktive me anë të koncerteve që i mban në vende të ndryshme të botës. Ora ka treguar se koncertet e shumta asaj i kanë mundësuar vetëm katër orë gjumë

brenda natës. "Unë u kam mbijetuar tri vendeve për tri ditë. I kam pasur nga katër orë gjumë në mes të tyre. Dhe e tani kam përfunduar këtu jo shumë sigurt", ka shkruar Rita Ora në rrjetin social "Instagram".

Ylli i NFL-it bëhet baba për herë të dytë



Ish-gojëtari i NFL-it, Devon Still, është bërë baba për herë të dytë. Këtë e ka bërë me dije vetë Devon, që tha se ai dhe gruaja e tij

Asha u bënë prindër të vajzës Arya Marie. "Ajo lindi në orën 02:12 të mëngjesit më 31 gusht. Ne jemi të bekuar", tha çifti, sipas "People".

| Autor: Gazmend Morina - BENI | VEGËL MUZIKORE ME FRYMË | KËNGËTARI I NJOHUR SPANJOLL IGLESIAS (shqip.) | KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (shqip.) | MOKMARGINA ORIGINAL CAPITAL | SHMANGIE NGA RREGULLI I ZAKONSHËM; ZHVILLIM JONORMAL | ISH FUTBOLLISTI JAPONEZ NAKATA | ZANORE | PERANDORI ROMAK ... CEZARI | NOMINIMET | AKTORJA E NJOHUR BRITANIKE WINSLET | | | | | | |
|--|---|--|--|--|---|---|---|---|---|--|---|--|--|--|---|---|
| AKTORJA E NJOHUR MEKSIKANE NË FOTO (shqip.) | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | | | | | | |
| JONI ME NGARKESE NEGATIVE | | | | | | | AKTORJA ME FAMË BOTËRORE TURMAN VENDLINDJA E ODISEUT | | | | | | | | | |
| ZVARRANIK I MADH, ME TRUP DERI GJASHTË METRA TË GJATË (sh.shq.) | | | | | | | | | | | | | | | | |
| SILIC, AZOT | | | | AKTORI HOLLIVUDIAN DEIMON BASHKËTING- ËLLORE | | | | NOTË MUZIKORE JO (ang.) | | | | | | | | |
| OLIVER KAHN | | | LANETI (hebr.) KRYEQYTETI I BIRMANISË (pashq.) | | | | | | EPOKA ERE | | | | | | | |
| KORREKT (sport) | | | | MAKINË QË TËRHEQ VAGONËT E TRENIT (sh.shq.) FUTBOLLISTI MESI | | | | | | | | | | | | |
| ZANORE | | KËNGËTARJA AMERIKANE KEJS (shqip.) FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO | | | | | | ELIZABETH TAYLOR QË KA TRUP TË SHËNDETSH- ËM (bised.) | | | | | | | | |
| FUTBOLLISTI PORTUGEZ LUIS | | | | | INTER QYTET I LASHTË NË ILIRI | | VOLT, TITAN FIJE E HOLLË PAMBUKU | | | MUZIKANTI YNË BAJRI | AKTORE E JONA | GURRA | MUAJ I VITIT QË I KA XXXI DITË (shq.) | PJATA | MOTRAT E NËNËS, TEZET (bised.) | IGLI TARE |
| EPOKA ERE | FUTBOLLISTI KROAT TUDOR DUATË, LUTJET QË I BËHEN ZOTTI (mysl.) | | | | | 3.14 (mat.) FLETË NOTASH PËR DISA INSTRUMENTE MUZIKORE | | | NDARJE E MADHE ADMINISTRAT- IVE NË PERANDORINË OSMANE (shq.) | | | | | | | |
| AFTËSI MBROJTËSE E ORGANIZMIT PËR TË MOS U PREKUR NGA NJË SËMUNDJE | | | | | | | | | GJERMANET E VJETRA E ARDHURA NGA PRONA MBI TOKËN | | | | | | | |
| APARTAMENTI | | | | | | | ZEJTARIA (pashq.) KUNDREJT I VJETËR | | | | | | | | | ZVOGËLIM DERI NË PIKËN MË TË ULËT (sh.shq.) |
| ABEDIN REXHA | | | E LËKUNDSHME NË QËNDRIME QË KA HUMBUR NJOMËSINË; E | | | | | | VSPANËSIRË FINLANDA, AUSTRIA | | | ZANORE E LODHUR SA GATI I ZIHET FRYMA | | EDVIN MURATI FILM I YNI "... DHE LISI" | | |
| DRITA | | BASHKËTING- ËLLORE PËSHPËRITUR FJALË MAGJIKE | | HIJESHI, BUKURI (turq.) SULFUR, IRIDIUM | | | | NAIM FRASHËRI PJESË E LOJËS NË "SPORTIN E BARDHË" (shq.) | | KËNGËTARJA BLEONA | | | | | | |
| BASKETBOLL- ISTI HAXHIBULLIQ | | | | | REGJISTRI NDESHA, ZATETA | | | | | FUTBOLLISTI SHQIPTAR BAJRAMI (Eifsborg) FUTBOLLISTI HAXHI | | | | | BASHKËTING- ËLLORE BANORI I KRYEQYTETIT TË FILIPINEVE | |
| KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE TIKARAM | | | | | | | DY ZANORE ERIADA (shk.) | | NËNË (turq.) PRESIDENTI I R. MADRID FLORENTINO | | | | LLOJ VETURE FRANCEZE STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI (sh.pashq.) | | | |
| PRINCIPATAT ARABE | | | | | | | | VEPËR E ERNEST HEMINGUEJ "..... DHE DET" VDEKJE (sh.shq.) | | | | | | ADRIAN MORINA AMERICAN MARITIME OFFICERS | | |
| | | | | SHËRIMET, MJEKIMET KURESHTJE | | | | | | | | NJË PLANET (shq.) | | | | |
| LARTËSIA E TRUPIT TË NJERIUT (pashq.) | SËMUNDJE QË SHKAKTOHET NGA RRIJTJA E TEPËRT E INDEVE (shq.) LLOJ GJELLE ME PATATE | | | | | | | ORINDA (shk.) AMERICAN ENGLISH LANGUAGE PROGRAMS | | SHKRIMTARI KELMENDI AKTORJA BRITANIKE ... FRIEL | | | | | | |
| KËNGËTARJA ADELINA | | | | | | STADIUMI I KLUBIT Bayern Munich "ALLIANZ" "M" para dy "E" | | | | | | | SHËNIM NË FUTBOLL (shq.) GROSETO | | | |
| ISMET SYLEJMANI QYTET NË SHQIPËRI | | | REGINA, ATALANTA JOD, INTENSITET | | | KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (orgj.) FOSFOR, LITËR | | | | PREJ KU SHKRONJA TË NJËJTA | | | | ADELINA MAMAQI UNITED NATIONES | | |
| | | | | | | FUTBOLLIST LEGJENDAR BRAZILIAN KANDAHARI | | | | SHKRONJA XIX dhe I ZANORE | | | FEMËR E SAPO MARTU- AR BASHKËTING- ËLLORE | | | |
| KITARIST I NJOHUR BRITANIK | | | | | | | | | | | PIKA ME E LARTË NË KUPËN E QIELLIT | | | | | |



Lexues të nderuar, për vërejtje dhe sugjerime mund të shkruani në: fjalekryqi_beni@yahoo.com & gazmend78@hotmail.com
 ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: SELMA HAJEK, ANIONI, UMA, KROKODILËT, SIN, MET, RE, OK, SATANI, FER, LOKOMOTIVI, O, ALISHA, ET, NANI, I, VTI, IGOR, PI, VIJAJETI, IMUNITET, ALËMANËT, BANESA, ARTIZANAT, AR, LABIE, RE, A, EM, D, V, NUR, NF, QERETI, ENES, LISTA, EMIR, N, TANITA, EA, ANE, AMI, EMIRATËT, PLAKU, AM, SHTAT, KURIMET, URANI, TUMORI, ORI, RAMI, PIREVA, ARENA, GOLI, IS, RA, METZ, GA, AM, KRUA, PELE, NA, NUSE, ERIK KLEPTON, KEINT.

80 vjet nga nisja e Luftës së Dytë Botërore, bombat e para ranë në Vielun

“Nga gjumi më zgjuan sirenat e alarmit. Në fillim nuk e dija, se çfarë po ndodhte. U ngrita nga shtrati dhe i pashë prindërit në ballkon. Nëna i tha babait, se ndoshta është një test alarmi. Edhe babai mendonte kështu dhe ishte i habitur, që kjo bëhej në orët e para të mëngjesit”, rrëfen Jan Tyszler, lindur në vitin 1933 në bisedë me Deutsche Ëellen. Në të vërtetë ranë bombat në Vielun – bombat e para të Luftës së Dytë Botërore.

Jan Tyszler kujton, se që në fund të gushtit 1939 “lufta ndjehej në ajër” dhe se gjithmonë flitej për të. Por askush nuk e kishte menduar, se qyteti i tij Vielun do të bëhej objekt sulmi i aviacionit ushtarak gjerman.

Vielun, më shumë se 200 kilometra në jugperëndim të Varshavës është sot një qytet i qarkut. Në vitin 1939 ai ndodhej vetëm 20 kilometra larg kufirit gjerman. Nga ana strategjike nuk kishte asnjë rëndësi. Ky

shkatërrimin e qytetit bask Guernica, ku mijëra civilë humbën jetën. Taktikën e atëherëshme të luftës me bombardime në stil të gjerë, një taktikë që pranonte edhe çmimin e vrasjes së civilëve si pjesë e luftës, von Richthofen mund ta riestonte në Vielun. Pa humbje për vete, sepse nuk llogaritej me rezistencë të qytetit ende në gjumë, e ku kishte shumë pak forca ushtarake.

Bombardimi i Vielunit shënoi krimin e parë të Luftës së Dytë Botërore. Në disa sulme ajrore nga ora 4:35 e mëngjesit deri në orën 14:00 pasdite qyteti u shkatërrua 70%.

Sulmit ndaj Polonisë i paraprinë disa aksione të trilluara, me të cilën makineria e propagandës së Rajhut të III kërkonte të justifikonte sulmin. Një nga provokimet më të njohura ishte sulmi kundër transmentuesit gjerman, Glajvitz (Gleiwitz) në afëri të kufirit polak. Në pasditen



© DW

jo më nën kontrollin e Rajhut. Porti, dogana dhe hekurudha ndodheshin në administrimin polak dhe pranë Balltikut, Polonia kishte stacionuar kazerma ushtarake dhe ushtrinë.

Më 1 shtator 1939, gjermanët sulmuan kazermën me municion. Sulmet kundër Gdanskut zgjatën afër një javë. Në një kohë që viktimat nga pala gjermane llogariten afër 3.400 vetë, nga pala polake flitet për 15 të vrarë. Në Poloni mbrojtja e Vesterplate para fuqisë së padiskutueshme ushtarake gjermane shihet si simboli i heroizmit polak. Prej dekadash fëmijët polakë mësojnë, se oficerët gjermanë kanë salutuar ushtarët polakë në nderim të luftës së tyre të guximshme, kur ata duhej të largoheshin të kapitulluar.

Kujtesa për Vielunin

Gdansk dhe Vesterplatte shihen ende sot si simbole të fillimit të

luftës. Në jubiletë përkujtimorë qeverisja e partisë PiS nuk haron të zbatojë politikën e saj aktuale. Që këtë vit si presidenti polak ashtu edhe qeveria nuk udhëtojnë në Gdansk në orët e para të mëngjesit, por në Vielun, ku për herë të parë është ftuar edhe presidenti gjerman, Steinmeier nuk është rezultat i ndonjë zbulimi të ri historisë.

Gdansk është një nga bastionet e fundit të opozitës në Poloni, ceremonitë përkujtimore aty përcaktohen shumë nga zërat e opozitës polake. Vesterplate është po ashtu një temë grindjeje mes PiS dhe opozitës liberale, që kryeson bashkinë. Kjo sepse PiS pjesën historike e ka integruar në Musuen e Gdanskut për Luftën e Dytë Botërore, e me këtë e ka kthyer në instrument të luftës së saj për ndërgjegjen historike të polakëve.

“Me siguri është më e lehtë të flasësh për ceremonitë përkujti-

more me dikë, që është më i hapur ndaj qendrave të pushtetit në Poloni, se me persona që janë më pak të afruar”, tha zëdhënësi i presidentit në pranverën e këtij viti, kur u mor vendimi që hapja e ceremonive përkujtimore të zhvendosej në Vielun. Me këtë ai indirekt përmend edhe atmosferën në qytetin Gdansk. Qytetarët aty janë ende nën shok pas vrasjes së kryetarit të bashkisë, Pavel Adamovicz.

Çdo vit në orët e para të mëngjesit të 1 shtatorit qytetarët e Vielunit zgjohen nga sirenat e alarmit, që kujtojnë sulmin e Gjermanisë naziste para 80 vjetësh. Jan Tyszler që ishte atëherë 6 vjeç, vjen çdo vit në Vielun. “Dëshira ime është që gjithmonë të dëgjojmë sirenat simbolike dhe kurrë më të vërtetat”, thotë 86 vjeçari. Vizitën e presidentit gjerman, Steinmeier në Vielun ai e sheh si një gjest që duhej bërë prej kohësh. DW



qytet nuk ishte as pikëlidhje rrugësh, nuk kishte urë, që duhej mbrojtur. Për këtë arsye ishin stacionuar shumë pak ushtarë polakë.

Krimet e para të luftës

“Që me bombat e para ne shkuam shpejt në oficinën në anë të shtëpisë, ku babai punonte si mekanik. Aty qëndruam në gropën, mbi të cilën kalonin makinat për kontroll. Dridheshim nga frika. Pasdite ishim të vetmit me shtëpinë ende të parrënuar. Të gjitha ndërtesat ishin shkatërruar.”

Familja e Jan Tyszlerit, si shumë familje të tjera e braktisi qytetin po atë ditë, kur Vehrmahti hyri në qytet gjeti vetëm disa qindra banorë. Sulmi kundër Vielinit me 87 bombardues u urdhërua nga Ëolffram von Richthofen. Në prill 1937 ai ishte kreu i shtabit të Legionit Condor, përgjegjës për

e 31 gushtit 1939 disa anëtarë të SS-ve erdhën në civil, por të armatosur për të transmentuar prej aty thirrjen për gjoja kryengritjen e polakëve që jetonin në Rajhun e III. Disa media të tjera gjermane raportuan për rebelët polakë në tokën gjermane, që me gjasë merrnin mbështetje edhe nga ushtria polake. Kështu Hitleri duke inskenuar gjermanët si viktime përpiqej të mobilizonte ushtarët e tij.

Sulmi në Vesterplate

Dhjetë minuta pas sulmit në Vielun pasoi bombardimi i Vesterplate, në afërsi të Gdanskut. Në këtë qytet gjermanët dhe polakët kishin një marrëdhënie të tensionuar. Gdansk u banuar kryesisht nga gjermanë, në Marrëveshjen e Versajës pas Luftës së Parë Botërore u deklarua qytet i lirë,



© privat

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandesi: Kundërshtarët janë të fortë, por të luftojmë si ekip

Trajneri Bernard Challandes i vlerëson maksimalisht kundërshtarët si Çekia dhe Anglia, por ka thënë se nëse "dardanët" duan rezultate pozitive, duhet të luftojnë si ekip. Strategu zviceran ka thënë se pesë mungesat në formacion vërehen jo vetëm te Kosova, por edhe te kombëtarët e mëdha siç është Franca. "Nëse Franca do të luante pa Griezmannin, Kanten, Pogban dhe Hernandesin nuk do të ishte ekipi i njëjtë i Francës. Njëjtë është edhe për Kosovën", ka thënë Challandes



na shkaktojë vështirësi, sepse ne jemi ekip më shtatshkurtër. Pa harruar edhe pjesën fizike të lojës që bëjnë çekët, mund të jetë sfidë për ne", ka shtuar ai.

'Kastrati i kërkoi garanci se do të luajë'

Trajneri zviceran foli edhe për sulmuesin Lirim Kastratin, duke zbuluar se ai ka kërkuar garanci se do të luajë. "Dhjetë ditë më parë kam bërë listën me Lirim Kastratin në të. Por në atë kohë, situata e Rashicës dhe Kolollit s'ishte e qartë. I thashë Lirimut hajde të hënën ushtrro deri të premten dhe të premten do të vendosë nëse do të qëndrojë me ekipin A ose jo. Nëse s'ka vend, luan për ekipin U-21. Ishte e qartë për mua dhe zgjidhje e mirë për të. Por në këtë javë mora thirrje nga agjenti dhe më tha se nuk jemi të lumtur me këtë zgjidhje. 'Ose garantoj Lirimut lojë për ekipin A ose ai nuk vjen'. Kurrë. Kurrë s'do të jap asnjë garanci për asnjë lojtar të kombëtares sonë. Është vendimi im. Kemi një ekip dhe nëse një lojtar merr ftesë, duhet të pranojë. E përsëris: Nëse pranoi ftesën, ju e pranoi rolin që keni në ekip", ka përfunduar Challandes.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë këtë muaj dy ndeshjet e radhës kualifikuese ndaj Çekisë dhe Anglisë. Trajneri Bernard Challandes të dielën në konferencë për medie ka thënë se "dardanët" nuk do ta kenë aspak të lehtë përballjen me kundërshtarët e radhës për faktin se kanë të lënduar pesë lojtarë të formacionit të parë. Dy futbollistët anësorë Arbër Zeneli dhe Milot Rashicën, si dhe dy mesfushorët qendrorë Hekuran Kryeziun dhe Herolind Shalën, si dhe mbrojtësi i majtë, Benjamin Kolollin, mungojnë në ndeshjet që zhvillohen më 7 dhe 10 shta-

tor. Trajneri zviceran ka bërë një krahasim interesant, duke thënë se edhe Franca pa Griezmannin, Kanten, Pogban dhe Hernandesin nuk mund të jetë kjo Francë që është për momentin. "Ne i kemi dy ndeshje shumë interesante dhe të rëndësishme kundër kundërshtarëve të fortë. Fatkeqësisht, i kemi disa lojtarë të rëndësishëm të lënduar. Si trajner më duhet ta pranoj këtë situatë dhe e di sa të rëndësishme janë këto mungesa. Nëse Franca do të luante pa Griezmannin, Kanten, Pogban dhe Hernandesin nuk do të ishte ekipi i njëjtë i Francës. Njëjtë është edhe për Kosovën", ka thënë Challandes, i cili ka shtuar se zëvendësimi i këtyre lojtarëve

kokë për kokë është i vështirë, por ka bërë me dije se do të mundohet që këtë problem ta rregullojë në mënyrë kolektive. "Si trajner mund të ankoem ose të gjej zgjidhje për lojtarët që mungojnë. Unë e kam zgjedhur opsionin e dytë dhe ideja ime është të reagojmë si ekip dhe t'i japim përgjigje këtij problemi si kolektiv. Detyrë e imja si trajner është që ta arrijmë të gjejmë më të mirën nga futbollistët që do të paraqiten në këto dy ndeshje. Duhet të jemi të qetë dhe të luftojmë jashtëzakonisht shumë dhe të japim më të mirën ndaj

Anglisë dhe Çekisë", ka deklaruar Challandes. Ndeshja e parë për Kosovën është më 7 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj Çekisë, kurse trajneri Challandes zbuloi pikat e forta të kësaj kombëtare. "I kam studiuar të dy kundërshtarët, veçanërisht Çekinë. Mund të themi se ata kanë një ekip shumë të fortë dhe se kanë bërë paraqitje të mira në dy ndeshjet e fundit kundër Bullgarisë dhe Malit të Zi. Sfidë tjetër për ne është edhe gjatësia e tyre, ngase janë 5-6 lojtarë që janë mbi 1.90 cm dhe kjo do të

Gjilani korrë edhe një fitore, derbi i takoi Feronikelit

Gjilani ka marrë edhe një trepikësh në elitë dhe tashmë renditet në pozitën e tretë me pikë të barabarta me Dritën dhe Feronikelin. Kampionët e "Niklit" e fituan derbin ndaj Prishtinës, kurse '89-shi ndau pikët me Drenicën

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Java e tretë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll përfundoi të dielën me dy ndeshjet e zhvilluara në Gjilan dhe Mitrovicë. Gjilani e ka mposhtur skuadrën e Vushtrrisë (2-0) dhe në këtë mënyrë ka konfirmuar se në këtë edicion ka një skuadër që mund të luftojë për trofe. Golin e parë në ndeshje e shënoi Tomislav Busiq në minutën e 44-t. Në pjesën e dytë vendësit ishin më këmbëngulës dhe shënuan edhe golin e dytë nëpërmjet Fiton Hajdarit (2-0). Në këtë mënyrë skuadra e Gjilanit, pas dy ndeshjeve, ka regjistruar dy fitore dhe një humbje, duke u pozicionuar në pozitën e tretë. Ndërsa Vushtrria e regjistron edhe humbjen e dytë në këtë kampionat dhe renditet



në pozitën e fundit. Në ndeshjen tjetër Trepça '89 dhe Drenica kanë luajtur baras 1-1. Vendësit shënuan në pjesën e parë nëpërmjet Richard Asare, por kuqezinjtë e barazuan rezultatin në pjesën e dytë me golin e Harmon Van-Dave. Ndërsa të shtunën janë zhvilluar tri ndeshje të tjera të kësaj xhiro në elitën e futbollit të Kosovës. Kampioni në fuqi, Feronikeli, e

mposhti skuadrën nënkampione, Prishtinën (1-0). Golin e vetëm në këtë ndeshje derbi e shënoi Mendurim Hoti në minutën e 9. Skuadra nga Drenasi në këtë mënyrë iu rikthehet fitoreve pas humbjes në xhiron e kaluar nga Ballkani. Ndërsa kryeqytetasit mbesin pa fitore nga dy ndeshjet e zhvilluara, pasi në ndeshjen e parë kishin luajtur baras me Flamurtarin. Fitore shumë të

| IPKO SUPERLIGA | | LIGA E PARË | | | |
|---|-----|----------------------------|---------------|---|---|
| Trepça '89 - Drenica | 1-1 | Vllaznia (P) - Malisheva | 3-4 | | |
| Gjilani - Vushtrria | 2-0 | Vëllaznimi - Drenasi | 1-1 | | |
| Feronikeli - Prishtina | 1-0 | Dardana - 2 Korriku | 0-2 | | |
| Llapi - Ballkani | 0-0 | Istogu - Onix | 2-0 | | |
| Flamurtari - Ferizaj | 1-0 | Liria - KEK-u | 1-0 | | |
| Dukagjini - Drita | 0-4 | Arbëria - Ramiz Sadiku | 4-2 | | |
| | | Vitia - Besa | 0-1 | | |
| | | Trepça - Ulpiana (shtyhet) | | | |
| TABELA | | TABELA | | | |
| 1. Drita | 3 | 6 | 1. Besa | 2 | 6 |
| 2. Feronikeli | 3 | 6 | 2. Istogu | 2 | 6 |
| 3. Gjilani | 3 | 6 | 3. Liria | 2 | 6 |
| 4. Trepça '89 | 3 | 5 | 4. Drenasi | 2 | 4 |
| 5. Ballkani | 3 | 5 | 5. 2 Korriku | 2 | 4 |
| 6. Drenica | 3 | 4 | 6. Malisheva | 2 | 4 |
| 7. Llapi | 3 | 4 | 7. Dardana | 2 | 3 |
| 8. Flamurtari | 3 | 4 | 8. Arbëria | 2 | 3 |
| 9. Ferizaj | 3 | 3 | 9. Vëllaznimi | 2 | 2 |
| 10. Prishtina | 2 | 1 | 10. KEK-u | 2 | 1 |
| 11. Dukagjini | 2 | 1 | 11. Vitia | 2 | 1 |
| 12. Vushtrria | 3 | 1 | 12. Onix | 2 | 1 |
| Në xhiron e radhës takohen: Ferizaj-Vushtrria, Drenica-Gjilani, Ballkani-Trepça '89, Prishtina-Llapi, Drita-Feronikeli, Flamurtari-Dukagjini. | | 13. Ulpiana | 2 | 0 | |
| | | 14. Trepça | 2 | 0 | |
| | | 15. Ramiz Sadiku | 2 | 0 | |
| | | 16. Vllaznia | 2 | 0 | |

rëndësishme ka shënuar edhe skuadra e Flamurtarit, e cila e ka mposhtur Ferizajn (1-0). Golashënues në sfidën e zhvilluar në kryeqytet ishte sulmuesi Shend Kelmendi në minutën e 28-të.

Ndërkohë ndeshja tjetër derbi e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë në mes të Llapi dhe Ballkanit përfundoi 0-0. Të premten Drita e kishte mposhtur Dukagjinin në Klinë (0-4).

Shkëndija shkarkon stafin teknik

TETOVË, 1 SHTATOR - Shkëndija ka nisur sezonin e ri në mënyrën më zhgënjyese të mundshme teksa numëron tri humbje dhe një barazim në katër javët e para, duke u renditur në vendin e fundit, rezultate këto që kanë vënë në lëvizje stafin drejtues.

Gjatë javës presidenti Lazim Destani kishte urdhëruar ngritjet e një grupi pune për ta analizuar situatën e krijuar te tetovarët, ndërsa tash erdhi edhe vendimi për ta shkarkuar stafin teknik. Largohet kështu trajneri Qatip Osmani, por edhe

ndihmësit e tij, teksa deri në emërimin e një trajneri të ri, drejtimi i skuadrës iu besua Erhan Selimit, sipas njoftimit të bërë nga klubi i Shkëndijës në faqen zyrtare. Qatip Osmani drejton Shkëndijën që prej qershorit të vitit 2017, teksa në dy sezone arriti ta

shpallë skuadrën kampione të Maqedonisë dhe të fitojë edhe një Kupë të shtetit, duke ngritur lart emrin e kuqezinjve. Megjithatë, dështimi i radhës për të kaluar në grupet e Ligës së Evropës, sidomos starti jashtëzakonisht i dobët, kanë bërë që drejtuesit të



ndërhyjnë dhe ta ndërpresin bashkëpunimin me të.

Basha: Kam vetëm një peng me kombëtaren

TIRANË, 1 SHTATOR - Migjen Basha ka zyrtarizuar largimin përfundimtar nga Kombëtarja e Shqipërisë pasi futbollisti i Arisit kërkonte më shumë kohë për të kaluar me familjen e tij, por edhe për t'ua hapur rrugën të rinjve. Jo shumë kohë të kaluar me fanellën kuqezi faktikisht, pasi për ta parë debutimin e mesfushorit 32-vjeçar do të prisnim vitin 2013. Aq shumë peripeci u kaluan në ato kohë për problemet e dokumenteve, pasi më herët kishte përfaqësuar të rinjtë e Zvicrës. Madje për disa çaste u duk se ishte e pamundur që Basha ta vishte fanellën e Kombëtares. Në një prononcim për "Sport Ekspres", lojtari në fjalë është shprehur se vendimin e tij ua ka bërë të qartë trajnerit Edy Reja dhe presidentit të FShF-së, Armand Duka. "Vendimin për t'iu larguar



Shqipërisë e kam marrë në qershor dhe i kam treguar arsyet e mia Rejës dhe pastaj Dukës. Në të gjithë këto arsye nuk ka asgjë negative apo polemikë ndaj trajnerit, shokëve të ekipit apo Federatës. Thjesht, për mua

ishte si momenti perfekt. Pengu im më i madh ishte fakti se nuk iu bashkova më herët Kombëtares së Shqipërisë, e gjitha kjo për shkakun e pasaportës që u vonua shumë", ka thënë Basha.

Rugova dhe Mylesi vazhdojnë me Prishtinën

Prishtinë, 1 shtator - KB Prishtina ka njoftuar se ka arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit me dy basketbollistët e njohur Fisnik Rugova dhe Divine Myles. "Qendra 208 cm e Përfaqësueses së Kosovës vazhdon të jetë pjesë e klubit tonë edhe për edicionin e radhës. KB Prishtina me këtë nënshkrim është duke tentuar që ta mbajë bazën e lojtarëve vendorë nga edicioni i kaluar për të pasur komponim sa më të mirë. Rugova ka filluar stërvitjet me klubin", thuhet në njoftimin e KB Prishtina. Ashtu si Rugova ka vepruar edhe Divine Myles. "Myles ishte fantastik në sezonin e kaluar duke u bërë pjesë e suksesit të klubit tonë në arenën evropiane. Myles karakterizohet me lojë të gjithanshme në të gjitha



repartet. Sa i përket lojës ofensive, Myles shquhet me depërtime të suksesshme, pasime, kërcime, si dhe precizitet të lartë pothuajse nga të gjitha pjesët e fushës. Në anën tjetër,

atletizmi si dhe persistenca e tij që gjithnjë të jetë përballë lojtarit kundërshtar e bëjnë Mylesin lojtar shumë të mirë në mbrojtje", thuhet në njoftimin e skuadrës kryeqytetase.

SHKURT

Torino kërkon Ujkanin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Samir Ujkani, pritet të rikthehet në futbollin italian. "Tuttomercato.web" raporton se interesim për Ujkanin ka shfaqur skuadra e Serisë A, Torino. Portieri në fjalë është larguar nga Rizespori, pasi hapësirat për të ishin shumë të vogla, kurse rikthimi në Itali pritet të jetë një zgjidhje e mirë për faktin se Ujkani edhe në të kaluarën ka qenë pjesë e futbollit italian.

Pesë skuadra në garë për Icardin

Afati kalimtar është drejt mbylljes, por e ardhmja e Mauro Icardit vazhdon të jetë e qartë. Interesim për lojtarin ka shfaqur Monaco, por edhe PSG-ja, Barcelona, Atletico Madridi dhe Valencia. "Sportmediaset" raporton se në Atletico e dëshirojnë argjentinasin për ta shtuar konkurrencën me Moratën dhe Costën, kurse Barça e sheh si zëvendësim në rast se largohet Dembele. PSG-ja, pas lëndimit të Cavanit dhe Mbappes, ka nevojë për një sulmues, kurse në skuadrën e Valencias e duan si zëvendësues të mundshëm të Rodrigues.

Nadali, 'leksion' Chungit, triumfojnë edhe Zverevi e Ciliçi

Është mbyllur raundi i tretë i grand slam të US Open për meshkuj. Rafael Nadali fitoi 3-0 (6-3, 6-4, 6-2) ndaj koreano-jugorit Chung Hyeon në një ndeshje formale për spanjollin. Nadali pati epërsi në të tre setet, duke e dominuar lojën dhe avancon më tej pa shumë mund. Vuan sërish, por siguron një biletë për në raundin e katërt edhe tenisti gjerman Alexander Zverev, numri 5 në botë. Ai mundi 3-1 slovenin Aljaz Bedene (6-7, 7-6, 6-3, 7-6). Kualifikohet për më tej edhe tenisi francez Gael Monls, që mundi 3-2 kanadezin Denis Shapovalov, një ndeshje maratonë mes dy tenistëve, që dhuroi shumë emocione. Kroati Marin Ciliçi, fitues i US Open në vitin 2014, mposhti 3-1 idhullin vendës John Isner, duke u kualifikuar për më tej. Në raundin e katërt shkojnë edhe rusi Andrey Rublev, spanjollli Pablo Andujar, italianii Matteo Berrettini si dhe argjentinasii Diego Schwartzman.

Vdes piloti Anthoine Hubert

Një aksident i frikshëm është regjistruar në Kampionatin Botëror të Formulës 2. Viktimë e kësaj ngjarjeje të rëndë ka mbetur piloti 22-vjeçar Anthoine Hubert. Aksidenti ndodhi gjatë Çmimit të Madh të Belgjikës me francezin që u përplas me makinën e amerikanit Juan Manuel Correas, teksa ishte me shpejtësi 273 km/h. FIA në një komunikatë zyrtare bëri me dije se Hubert menjëherë pas aksidentit u dërgua në spital dhe ndërroi jetë në orën 18:30 me orën lokale, ndërsa Correa u transportua në një spital të Lieges dhe është në gjendje stabile. Gara u ndërpre menjëherë pas aksidentit, për t'u anuluar pak minuta më vonë. Hubert, që garonte me skuadrën BWT Arden renditej në vendin e 8-të në klasifikimin e përgjithshëm të kampionatit dhe këtë sezon kishte regjistruar 2 fitore në Monaco dhe në Francë.

Leclerc shijon fitoren e parë në Formula 1

BRUKSEL, 1 SHTATOR - Charles Leclerc ka fituar Çmimin e Madh të Belgjikës, duke siguruar suksesin e parë në karrierën e tij dhe duke kthyer

Ferrarin në shkallën më të lartë të podiumit pas një agjërimit të gjatë. Leclerc ka qenë shumë i shpejtë gjatë gjithë fundjavës, duke bërë

paraqitje të shkëlqyera në provat e lira dhe duke siguruar "pole-position", para shokut të skuadrës Sebastian Vettelit, i cili ka dalë i katërti

në garën e sotme. Vendi i dytë dhe i tretë janë zënë nga dy pilotët e Mercedesit, Lewis Hamilton dhe Valtteri Bottas.





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Divizioni i Auditimit

Numri i Konkursit: APF0006005

Vendi i punës: Auditor i Brendshëm - AU/020 (1 pozitë)

Koeficienti: 15

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin marr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për bërjen e auditimeve edhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen/udhëheq auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgatit draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bënë intervistën përfundimtare;
- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësisve organizative;
- Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët në njësinë e auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës;

Kualifikimi i nevojshëm:

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e auditimeve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtues, analitik, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare ekonomike, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik, minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Të ketë kryer me sukses trajnimin rigoroz profesional dhe testimin për auditor të brendshëm, të jetë i certifikuar, të jetë i licencuar, të zhvilloj vazhdimisht njohuritë, shkathësitë, aftësitë profesionale për të ruajtur licencën për auditor të brendshëm dhe ruajtjen e licencimit duke marrë pjesë në trajnime në minimum 30 orë brenda vitit si dhe të ruajnë certifikimin e tyre profesional në fusha të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm si: auditim të brendshëm, kontabilitet, financa, menaxhim në sektorin;

Procedura e konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në Ndërtesën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, rr Bajram Kelmendi K1-L1 edhe në Web faqen <http://www.min-rks.net>

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e situara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuar nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Rruga Bajram Kelmendi K1L1 Prishtinë ose me postë.

Informata e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kohëzgjatja e kontratës sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i konkurrimit është prej datës 02/09/2019 deri me datë 16/09/2019, deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 00381 38 200 69 512



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Ministarstvo za inovacije i preduzetništvo u skladu sa Zakonom o civilnoj službi Republike Kosovo Z. br. 03/L-149 i Uredbom br. 02/2010 o procedurama regrutovanja u civilnoj službi Republike Kosova, raspisuje:

OGLAS ZA ZAPOSŁJAVANJE

Divizija za reviziju

Broj konkursa: APF0006005

Radno mesto: Interni revizor - AU/020

Koeficient: 15

Trajanje imenovanja: Na neodređeno

Dužnosti i odgovornosti:

- U saradnji sa nadzornikom učestvuje u izradi plana revizije i usvaja planove rada i rokove za vršenje revizije i relevantnih usluga;
- Vrši/rukovodi revizijama, uključujući uvodne intervjuje u sektoru koji se revidira, intervjuje osoblje, preuzima i analizira relevantnu dokumentaciju i evidentira nalaze;
- Priprema nacrt izveštaja, diskutuje sa nadzornikom i realizuje završni intervju;
- Izrađuje konačni izveštaj, sa adekvatnim preporukama, dovršava dosije revizije i dostavlja istu za arhiviranje;
- Prati sprovođenje preporuka od strane institucija i organizacionih jedinica;
- Daje uputstva osoblju nižeg nivoa u jedinici za internu reviziju za izvršavanje njihovih dužnosti i odgovornosti;
- Daje savete o pitanjima interne revizije u okviru institucije, po potrebi;
- Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira sa spoljnim organima, po potrebi;

Potrebne kvalifikacije:

- Suštinsko znanje i iskustvo u oblasti revizije;
- Poznavanje primenljivih zakona i uredbi;
- Komunikacione veštine u planiranju rada i vodenju tima;
- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine u formulisanju preporuka i stručnih saveta;
- Računarske veštine u radu sa programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);
- Univerzitetska diploma, ekonomija, javna uprava, javne finansije, računovodstvo ili pravni fakultet, najmanje 3 godine stručnog radnog iskustva;
- Da ima uspešno završenu rigoroznu stručnu obuku i test za interne revizore, da poseduje sertifikat, licencu, da neprekidno razvija stručno znanje, veštine, sposobnosti za održavanje licence za interne revizore, učestvujući u obukama najmanje 30 časova u roku godine, kao i da održava stručni sertifikat u različitim oblastima sistema za unutrašnju kontrolu, kao što su: interna revizija, računovodstvo, finansije, upravljanje sektorom;

Postupak konkurisanja

Postupak konkurisanja je otvoren za spoljne kandidate i postojeće civilne službenika koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Prijava za zapošljavanje i opis poslova mogu se preuzeti u zgradi Ministarstva za inovacije i preduzetništvo, ul. Bajram Kelmendi K1-L1 i na internet stranici <http://www.min-rks.net>

Aplikacijtreba priložiti prateću dokumentaciju, kao što su: Popunjeni obrazac za apliciranje, dokaz o obrazovnoj i stručnoj spremi (diplome stečene u inostranstvu treba da budu nostrifikovane od strane MONT-a), dokaz o radnom iskustvu, dve preporuke.

Upotreba pogrešnog i nkompletnog obrasca sa zahtevanim podacima smatrać se nevažećim. Prijave se dostavljaju u Ministarstvu za inovacije i preduzetništvo, ulica Bajram Kelmendi K1-L1 Priština ili poštom.

Opšte informacije za sve kandidate

Ministarstvo za inovacije i preduzetništvo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu. Nevećinske zajednice imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe, kao što je utvrđeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo. Trajanje ugovora prema ZCS-u, treba obuhvatiti i period probnog rada.

Zbog velikog broja primljenih prijava, biće kontaktirani samo kandidati koji ulaze u uži izbor.

Rok za konkurisanje je od 02/09/2019 do 16/09/2019, u 16:00 časova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objavljivanja u dnevnom novinama.

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma za konkurisanje neće biti primljene. Za dodatne informacije, molimo vas pozovite na broj telefona: 00381 38 200 69 512



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCËVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar i Personelit 1- 2 (dy) pozita

Departamenti : DFSHP

Divizioni: I Burimeve Njerëzore

Kategoria funksionale: Koeficienti : 7

Numri i referencës: 53/2019

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Kujdeset që proceset e rekrutimit të zbatohen në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil;
2. Kujdeset që shpalljet për publikim e vendeve të lira të punës të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara me rregulloret përkatëse;
3. Pranon, regjistron dhe verifikon aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozita të lira të punës;
4. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për komisionin lidhur me procesin e rekrutimit;
5. Siguron që listat e pagave të stafit të institucionit janë përgatitur në pajtim me procedurat ligjore;
6. Përditëson dosjet e personelit me të dhëna dhe dokumente relevante dhe kujdeset që të gjitha llojet e pushimeve të stafit janë proceduar në pajtim me procedurat ligjore;
7. Përgjegjës për raportim të punës të përgjegjësi kompetent për dhënie të shënimeve dhe raporteve lidhur me të gjitha kërkesat e pranuar dhe për parregullsive eventuale;
8. Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri profesionale specifike në fushën e burimeve njerëzore;
2. Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
3. Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
4. Shkathtësi hulumtuuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacionet e programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare në drejtimet shoqërore ekonomike dhe juridike pa përvojën, ose shkollë të lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 15 (Pesëmbëdhjetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 16.09.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës”. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCËVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Z. br.03/L-149 i Uredbe Br.02/2010, o Procedurama Rekrutiranja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik Osoblja 1- 2 (dve) pozicije

Divizija: Ljudskih Resursa

Funkcionalna kategorija: Koeficijent : 7

Referentni broj: 53/2019

Odgovara: Rukovodiocu Divizije Ljudskih Resursa

Mesto: Priština

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodioca Divizije Ljudskih Resursa, obavlja dolo navedene dužnosti i odgovornosti:

1. Osigurava da se procesi regrutovanja sprovede u skladu sa zakonodavstvom o civilnoj službi;
2. Osigurava da objavljeni oglasi o slobodnim radnih mesta su u skladu sa standardima utvrđenim odgovarajućim propisima;
3. Prima, registruje i proverava aplikacije kandidata koji su aplicirali za slobodna radna mesta;
4. Priprema potrebnu dokumentaciju za komisiju u vezi sa procesom regrutovanja;
5. Osigurava da se platni spisak osoblja institucije bude pripremljen u skladu sa zakonskim procedurama;
6. Ažurira dosije osoblja sa relevantnim podacima i dokumentima i osigurava da se sve vrste odmora osoblja obrađuju u skladu sa zakonskim procedurama;
7. Odgovoran za izveštavanje o radu nadležnim odgovornim za dostavljanje evidencija i izveštaja o svim primljenim zahtevima i eventualnim nepravilnostima;
8. Vrsi druge dužnosti u skladu sa važećim zakonima i propisima koje nadzornik razumno može povremeno zahtevati;

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike :

1. Specifična profesionalna znanja iz oblasti ljudskih resursa;
2. Sposobnosti rešavanja problema za tehnička ili proceduralna pitanja koja proizilaze iz procesa rada;
3. Sposobnosti da organizuju svoj rad i koordiniše osoblje na administrativnom nivou;
4. Istraživačke, analitičke i informacione i ocenjivačke veštine;
5. Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Univerzitetska Diploma iz društvenih, ekonomski i pravnih struka i to bez radnog iskustva, ili viša škola sa najmanje dve (2) godine radnog iskustva.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Trajanje imenovanja : Imenovanje je na neodređeni rok.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana.

Zadnji datum za apliciranje je: 16.09.2019

Aplikacije koje se šalju putem pošte, sa poštanskim markicama, na poslednji datum konkursa, smatraju se važećim.

Podnošenja zahteva: Aplikacija se preuzima sa veb stranice MKOS-a, i dostavlja se na kancelariji 27 Ministarstva kulture, omladine i sporta, adresa: Trg „Majke Tereze“ br. 44, Priština. Za dodatne informacije stupite u kontakt na broj telefona 038 211 449 i 038 211 921, ili na veb stranici <http://www.mkrs-ks.org/>). „Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog i od svih zajednica na Kosovu. Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe unutar javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11. Stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova. Aplikacije poslate nakon zadnjeg datuma kao i ne kompletirani aplikacije, neće se primiti. Zbog velikog broja primljenih aplikacija, kontaktirajte se samo kandidati koji su odabrani u užoj listi.



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 317 /1
 Datë: 30.08.2019

KONKURS

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së tretë për Nivelin e 5-të, të kualifikimit “Asistent për nxënës/fëmijë me nevoja të veçanta arsimore” në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj përkatësisht në paralelet e saj në Prishtinë dhe Pejë për vitin shkollor 2019/2020

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve

Për regjistrimin e kandidatëve për Nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, për vitin shkollor 2019/2020, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë dhe të janë më të vjetër se 18 vjeç.

Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë (niveli 4 i kualifikimit).

2. Ofrimi i kualifikimit

Në këtë vit akademik, kualifikimi do të ofrohet në dy grupe – Prishtinë dhe Pejë. Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Ferizaj si Institucion i akredituar nga PEARSON dhe dy paralelet e saj të ndara në Qendra Burimore në Prishtinë dhe Pejë.

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me diplomë sipas standardeve të BTEC e cila do të jetë e njohur ndërkombëtarisht në mbi 70 vende të botës.

4. Kreditë

Kualifikimi për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” zgjat një vit akademik dhe vlerësohet me 120 kredi (1200 orë) të Arsimit dhe Aftësisit Profesional.

5. Paguesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve pasi të pranohen, të paguajnë shumën prej **300 Euro**.

6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Fletëparaqitjen e cila merret në Agjencionin për Arsim dhe aftësim profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) dhe/ose në Qendrën Burimore “Xheladin Deda” në Pejë;
- ✓ Kandidatët të cilët konkurojnë
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë diplomuar pas vitit shkollor 2015/2016;
- ✓ Certifikatën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm të lartë para vitit shkollor 2014/2015;
- ✓ Diplomë tjetër të shkollimit të lartë, nëse e posedon kandidati;
- ✓ Certifikata relevante, nëse i posedon kandidati;
- ✓ Dëshmi e përvojës së punës, nëse kandidati ka përvojë;
- ✓ Certifikatën e lindjes.

7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës: 02. Shtator 2019 – 06. Shtator 2019

Për grupin/paralelen e Prishtinës paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë, ndërsa për grupin/paralelen e Pejës e cila i përfshin komunat Pejë, Decan, Junik, Istog, dhe Klinë, paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën Burimore “Xheladin Deda” në Pejë, rruga “Bill Klinton” nr.183 duke filluar nga ora 10.00-14.00, si dhe për të dy grupet në formë elektronike në e-mail adresën xhevahire.pllana@rks-gov.net.

Kandidatët, do të ftohen për testin e bazuar në kompjuter, sipas standardeve të testimit përmes programit të Basic Check dhe testit me shkrim me datë: 13. Shtator 2019, në sallën e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës, “I Hasan Prishtina”

Rezultatet për pranimin e kandidatëve shpallen në AAAPARr/Qendrën Burimore “Xheladin Deda” Pejë me datën: 20. Shtator 2019.

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet me datë: 21. Shtator 2019.

Kandidatët e refuzuar të cilët dyshojnë se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t’i paraqes ankesë në Agjencinë e Arsimit dhe Aftësisit Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

8. Kriteret e regjistrimit

Me qëllim që të garantohet një proces transparent i regjistrimit dhe të promovohet procesi i shkathhtësive të orientuara në merita, kandidatët të cilët i plotësojnë kërkesat minimale për aplikim do të ftohen për testim.

Kandidatët që vlerësohen në bazë të rezultateve të testit Basic Check dhe testit me shkrim, do të pranohen sipas pikëve maksimale.

Lumë's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumedetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Dëshmoret e Vrrinit"-Billushë

Komuna: Prizren

Data: 02.09.2019

Emri i kontratës: Blerja e mjeteve te Teknologjisë

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/084 - ESIP/SDG/84-G/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Dëshmoret e Vrrinit"-Billushë, Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i mallrave të nevojshëm:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshëm:

- 4 Llaptopa

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik dhe termeve të referencës në adresën e Shkollës "Dëshmoret e Vrrinit"- Billushë, Prizren më së largu deri më 10.09.2019

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Personi kontaktues: Eral Babuna

Telefoni: 044/640-928

E-maili: ermalbabuna@gmail.com

Kërkesë për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Nefit Jusufi"

Komuna: Prizren

Data: 02.09.2019

| | |
|---------------------|---|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/088-CS/1.1 | Trajnim: Strategjitë e nxënies eksperienciale |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe ShFMU "Nefit Jusufi" Skorobisht, Prizren. Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës së nevojshme: Trajnim: Strategjitë e nxënies eksperienciale.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën të cilën e kërkon trajnimi;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit do të realizohet në përputhje me Udhëzimin "Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat konsulente të interesuara që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lart, janë të mirëseardhura të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesit për shërbime konsulente në adresën: ShFMU "Nefit Jusufi" Skorobisht, Prizren, më së largu deri më datën: 10.09.2019. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termet e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ramit Jusufi

Telefoni: 044 621 341

E-maili: shfmunefitjusufi@gmail.com



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D. D.

FTESË PËR OFERTË

Procedure e shitjes në bazë të rregullores së KRPP-së - Rregullat mbi Qeverisjen e Shitjes dhe Vendosijeve të Aseteve, datë 24 Janar 2012, dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderimit të KEK, për Shitje të Aseteve të Luajtshme, datë 15 Shtator 2009

SHITJA E QYMYRIT

Ri-shpallje

Procedure e Shitjes

Nr. KEK-SHQ -19-001-811

Korporata Energjetike e Kosovës sh. a. (KEK), me këtë rast, fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë dokumentet e tenderimit.

Metoda që do të përdoret -shitja përmes ofertave publike të mbyllura për sasinë: **250,000 t** Blerësi fitues do të marrë qymyrin me pajisje disokontinuale në minierën e Sibovcit Jugperndimor, duke përdorur pajisjet vetjake – për përdorim vetjak apo për shitje të mëturshme.

Ky aktivitet do të zhvillohet me procedurë të hapur me një zarf

Vizita në Vendndodhje : 09.09.2019 prej orës 10:00- KEK, Divizioni i Prodhimit të Qymyrit, Drejtoria Hyrja 01, Kastriot - e deshirueshme

KEK fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre me se voni me datë 18.09.2019 në ora 13:00, ndërsa hapja e ofertave në ora 13:30.

Kërkesat për tërheqjen e dosjes së tenderit drejtohen në adresat vijuese:

Email: emin.tmava@kek-energy.com ose minator.ferizi@kek-energy.com

www.kek-energy.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 €uro kontakti 044-171328.

▶ "G-Goat Group" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810098170.

▶ Pllana Pharm shpallë certifikatën e TVSH-së, me nr. 330393661 dhe me nr fis. 810135500.

▶ Arbona Zenullahu shpallë të pavlefshëm INDEX-in, e Kolegjit "Dardania" Prishtinë.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studentë ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e vashet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Shpall konkurs për pranimin e fëmijëve të moshave të ndryshme (0,9 - 6 vjeç)

Aplikimi për regjistrim të fëmijëve fillon nga data:
10.08.2019 deri 30.08.2019

Për çdo informatë shtesë mund të drejtoheni përmes telefonit 045 714 713.

